



RAPORTI VJETOR 2021

PËRMBAJTJA

RAPORTI VJETOR 2021	1
HYRJE	6
I. FUNKSIONIMI I DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE TATIMEVE	6
Misioni	6
II. REALIZIMI I TË ARDHURAVE	8
1. Menaxhimi sipas objektivave	8
2. Të ardhurat e vitit 2021	8
Grafik 1. Struktura e të ardhurave	11
Tabela 1. Totali DPT 12 Mujori 2021	12
Tabela 2. Të ardhurat e realizuara për vitin 2021 sipas DRT-ve (000 leke)	13
Tabela 3. Të ardhura nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (000 leke)	14
Tabela 4. Te ardhura nga Tatimi mbi Fitimin (000 leke)	14
Tabela 5. Te ardhura nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (000 leke)	15
Tabela 6. Krahاسimi TAP sipas zerave (000 leke)	15
Tabela 7. Të ardhura nga Taksat Kombëtare dhe Tarifa (000 leke).....	16
Tabela 8. Taksat Kombëtare dhe Tarifat sipas llojeve (përfshirë Tarifa Buxhetore)	17
Tabela 9. Të ardhura nga Taksa e Qarkullimit Rrugor (000 leke)	18
Tabela 10. Të ardhurat nga sigurimet shoqërore & shëndetësore.....	18
3. Sektori i Kontabilitetit dhe Pagesës.....	18
III. SHËRBIMI I TATIMPAGUESVE	23
I - Asistenca dhe shërbimi për tatimpaguesit	23
II. Sektori i Thirrjeve dhe struktura organizative.....	26
III- Sektori i Regjistrimit ne DPT eshte perqendruar ne keto drejtime kryesore:.....	27
IV. PERFORMANCA TEKNIKO-LIGJORE	31
HYRJE	31
SEKTORI I ÇËSHTJEVE LIGJORE	31
SEKTORI I TVSH-SË DHE TAKSAVE TË TJERA	33
Tabela.1. Hyrje _Praktika_per Trajtim_2021.....	34
Tabela Nr.2 Permbledhje e praktikave te trajtuara _v.2021.....	35
Tabela nr.3 .Praktika te mbartura nga v.2020, trajtuar ne v.2021	36
V. KONTROLLI TATIMOR	39
1. Përzgjedhja për Kontroll.....	40
2. Objektivat për vitin 2021.....	40

3. Aktivitete të realizuara për vitin 2021	43
VI.MENAXHIMI I RISKUT	45
1. Objektivat e Drejtorise per vitin 2021	45
2. Aktivitet e programuara dhe realizuar gjate vitit 2021 ne funksion te realizimit te objektivave.	46
2.1 Permiresimi i Modulit te Riskut(rishikuar)	49
2.2 Analizimi i riskut te tatimpaguesve qe bejne Kerkese per Rimbursim	51
2.3 Ndryshimi i pergjegjesive tatimore bazuar në të dhenat e paisjeve fiskale dhe deklaratat mujore të TVSH-së. 51	
3. Analiza periodike per tatime te vecanta dhe per sektore te caktuar	52
4. Fiskalizimi.....	53
5. Te tjera aktivitete te realizuara nga DMR gjate vitit 2021	53
VII. MBLEDHJA ME FORCË.....	54
Grafiku 1. Detyrimet sipas Llojit të Tatimit	55
Grafiku 2. Detyrimet sipas llojit të Tatimit 2020 vs 2021	55
Grafiku 3. Detyrimet sipas statusit te tatimpaguesit	56
VIII. RIMBURSIMI I TVSH-SË.....	58
Objekti dhe detyrat e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së.....	58
Baza Ligjore	58
Aktivitetet e programuara dhe realizuara për vitin 2021.....	60
Trajtimi dhe Rimbursimi i kerkeseve per rimbursim te TVSH-se sipas afateve ligjore;	60
Rishikimi i Rregullores së Rimbursimit të TVSH-së	63
Ndryshime Neni 10 "Përcaktimi i kategorisë së eksportuesve për qëllim të rimbursimit të TVSH-së";	64
Publikimi i Stokut të Rimbursimit të TVSH-së;	64
Automatizimi i sistemit te trajtimit te kerkeseve per rimbursim.	65
IX. DREJTORIA E VERIFIKIMIT DHE KOORDINIMIT NË TERREN	66
1. Organizimi	66
2. Qëllimi	66
3. Objektivat:.....	66
4. Realizimet.....	66
Grafiku 1: Verifikimet dhe Shkeljet e DVKT-së	67
Grafiku 1: Verifikimet dhe Shkeljet e DVKT-së	67
Grafiku 2: Vlera e Shkeljeve sipas rajoneve të DVKT-së	67
Grafiku 3: Shkeljet kryesore të DVKT-së në përqindje	68
5. Denoncime/Ankesa	68
X. MARRËDHËNIET DHE KOORDINIMI INSTITUCIONAL DHE MENAXHIMI I PROJEKTEVE.....	71

1. Hyrje.....	71
2. Objektivat për vitin 2021.....	72
3. Aktivitetet e programuara dhe realizuara gjatë 2021 në funksion të realizimit të objektivave.	72
4. Sa dhe si ndikuan këto aktivitete në arritjen e objektivave të përcaktuara.	74
XI. BURIMET NJEREZORE.....	75
REKOMANDIME TË FMN-së (2020-2021).....	76
AKTIVITETE NË VITIN 2021.....	77
TRAJNIMI DHE NGRITJA E KAPACITEVE TË BURIMEVE NJERËZORE	78
MASAT DISIPLINORE	80
TË DHËNAT PËR VLERËSIMET E REZULTATEVE NË PUNË PËR VITIN 2021.....	81
XII. BUXHETI DHE FINANCA	83
Tabela 1. Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve Viti 2021	83
Tabela 2. Raporti i Shpezimeve sipas artikujve buxhetore Viti 2021	83
Tabela 3. Projektet e investimeve	84
XIII. DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PROKURIMEVE	86
Problematikat	89
XIV. DIBA.....	90
XV. Drejtoria e Kontrollit të Specializuar	90
Objektivat e Drejtorise.....	90
Struktura Organizative	90
Aktivitetet DKS gjatë Vitit 2021.....	91
XVI. DREJTORIA PËR PROCESET E BIZNESIT	92
Varësia sipas strukturës organizative të DPT dhe historiku i krijimit	92
Organizimi i Drejtorise për Proceset e Biznesit.....	92
Aktiviteti i Drejtorise për Proceset e Biznesit gjatë vitit 2021	93
Bashkëpunimi me palët e treta.....	93
Veprimtaritë e kryera dhe në proces	94

Raporti vjetor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është një dokument publik, i cili ngarkohet në faqen zyrtare të internetit, www.tatime.gov.al

Shkurtime	
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DRT	Drejtoria Rajonale Tatimore
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
TAP	Tatimi mbi të Ardhurat Personale
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
RPA	Regjimi i Përpunimit Aktiv

HYRJE

I. FUNKSIONIMI I DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE TATIMEVE

Misioni

Administrata Tatimore Qendrore administron mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe kontributeve shoqërore, duke nxitur përmbushjen vullnetare dhe duke kërkuar nga të gjithë kuptimin dhe respektimin e detyrimeve ligjore.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është autoriteti shtetëror i specializuar, në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për krijimin, sigurimin dhe mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

Institucioni është i organizuar në nivel qendror me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përgjegjëse për hartimin, monitorimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave operacionale efikase në realizimin e misionit të institucionit. Në nivel rajonal, institucioni ka 14 Drejtori Rajonale Tatimore dhe në total në organikën e administratës tatimore shqiptare numërohen 1305 punonjës (fakt 2021) duke e renditur administratën tatimore si një nga institucionet ligj zbatues më të rëndësishme në vend.

Në këtë frymë, administrata tatimore nisur edhe nga praktikat e shumë vende anëtare të BE-së që kanë ndryshuar qëndrimin e tyre ndaj taksapaguesve, duke u larguar nga monitorimi i njëanshëm i përmbushjes së detyrimeve tatimore, u orientua drejt një marrëdhënieje proaktive dhe partneriteti me tatimpaguesit, duke investuar në forcimin e besimit të tatimpaguesve në përmbushje të nevojave të tyre. Përvoja tregon se tatimpaguesit e informuar kanë më shumë gjasa të përmbushin detyrimet e tyre në mënyrë të rregullt dhe kjo ka dhënë efekte të matshme e pozitive të cilat do t'i gjeni në treguesit statistikorë në këtë raport.

Të dhënat e vitit 2021 tregojnë se angazhimi serioz në luftën kundër informalitetit ka dhënë efektet e pritura të cilat shërbejnë si indikator për rritjen e besimit dhe sigurimin e një mjedisi të shëndoshë ekonomik.

Objektivat strategjikë nga të cilat AT udhëhiqet janë:

- Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare, përmes:
 - Ofrimit të shërbimeve cilësore dhe reduktimit të barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore.
 - Rritjes së ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë dhe kuptimin e rolit të Administratës Tatimore në shoqëri.

- Zbatimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor, përmes:
 - Zbatimit të strategjisë së përmbushjes së menaxhimit të riskut,
 - Përmirësimit të mëtejshëm të kontrollit tatimor dhe gjurmimit të mashtrimeve tatimore,
 - Mbledhjes efikase dhe efektive të borxhit,
- Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, përmes;
 - Aplikimit të metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një administratë tatimore moderne,
 - Zhvillimit të kapaciteteve dhe motivimit të punonjësve,
 - Mbajtjes së proceseve optimale dhe strukturës së Administratës Tatimore,
 - Zhvillimit dhe përmirësimit të partneriteteve,
 - Modernizimit dhe rinovimit të infrastrukturës,
 - Kënaqësia nga shërbimet elektronike të tatimeve është dukshëm më e lartë në 2021 në të tëra aspektet e vlerësuara, si aksesit, besueshmëria dhe saktësia e përpunimit të të dhënave,
 - Një rritje e konsiderueshme në vlerësimin për cilësinë e raportit të auditimit, si dhe sjelljen dhe etikën e inspektorëve,
 - Një rritje të ndjeshme në ndërgjegjësimin e tatimpaguesve për Modulin e Analizës së Riskut dhe përzgjedhjen për inspektim bazuar në të.

II.REALIZIMI I TË ARDHURAVE

1. Menaxhimi sipas objektivave

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2021 një ndër objektivat kryesor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ka qenë:

- Rritja e pajtueshmërisë vullnetare,
- Rritja e performancës së mbledhjes të të ardhurave tatimore mbi parashikimet aktuale
- Përmirësimi dhe sigurimi i shërbimeve më të mira për tatimpaguesit,
- Reforma kundër informalitetit dhe fokusi në mirë-administrim,
- Trajnimi i vazhdueshëm për nënpunësit e të gjitha niveleve.

Në arritjen e objektivave janë mbajtur në konsideratë:

- Përmirësimi i administrimit të mbledhjes së tatimeve me efekte në rritjen e tyre.
- Efektet e paketës fiskale për vitin 2020.
- Forcimi i mbledhjes së taksave bazuar në strategjinë e riskut të pajtueshmërisë.
- Përzgjedhja dhe trajnimi i stafit të administratës tatimore.

2. Të ardhurat e vitit 2021

Administrata Tatimore Qendrore, për periudhën 12 mujore 2021, paraqet një performancë pozitive në mbledhjen e të ardhurave. Vendosmëria e administratës për të luftuar evazionin dhe ekonominë informale, si dhe fushatat sensibilizuese të ndërmarra kanë ndikuar në prirjen rritëse të të ardhurave.

Struktura e të ardhurave

Struktura e mbledhjes së të ardhurave përbëhet nga:

- Të ardhurat tatimore neto përbëjnë **57.6%** të të ardhurave totale neto.
- Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore përbëjnë **42.4%** të të ardhurave totale neto.

Për vitin 2021, të ardhurat tatimore bruto gjithsej janë programuar 266.2 miliard lekë dhe janë realizuar 274.9 miliard lekë, me një realizim në vlerë prej 8.8 miliard lekë ose 3.3 % më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, me realizim të ardhurash 235.5 miliard lekë, rritja e të ardhurave tatimore është 39.5 miliard lekë më shumë ose 16.8 % më shumë.

Nga të dhënat statistikore të evidencës së realizimit të të ardhurave për këtë periudhë rezulton:

Të Ardhurat Tatimore

Për vitin 2021, të ardhurat tatimore janë programuar 168.7 miliard lekë dhe janë realizuar 168.7 miliard lekë, me një mosrealizim prej 32 milion lekë ose 0.02 % më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, në të cilën të ardhurat u realizuan 141.4 miliard lekë, rezultatet janë në rritje me 27.3 miliard lekë ose 19.3 % më shumë.

Të Ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore

Për vitin 2021, të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore janë programuar 97.5 miliard lekë dhe janë realizuar 106.3 miliard lekë, me një rritje prej 8.8 miliard lekë ose 9.04% më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, ku të ardhurat nga KSSHSH ishin 94.1 miliard lekë, rezultatet janë në rritje me 12.1 miliard lekë ose 12.9 % më shumë.

2.1. Të Ardhurat Tatimore ndarë sipas llojit

Realizimi i të ardhurave sipas llojit të tatimeve krahasuar me planin e vitit 2021 dhe faktin e vitit 2020, për periudhën Janar – Dhjetor 2021, bazuar në të dhënat statistikore, paraqitet si më poshtë:

2.1.1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Për 12 mujorin 2021, të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (neto) ishin programuar në vlerën prej 41.3 miliard lekë dhe janë realizuar në vlerën prej 30.4 miliard lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 10.9 milionë lekë ose 26.5% më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, në të cilën u arkëtuan 29.7 miliard lekë, të ardhurat nga TVSH-ja neto janë arkëtuar 0.7 miliard lekë ose 2.4% më shumë.

2.1.2. Rimbursimi i Tvsh-së

Për 12 mujorin 2021 rimbursimi për TVSH-në ishte programuar 17.0 miliard lekë dhe është realizuar në vlerën 24.1 miliard lekë me një realizim prej 7.1 miliard lekë ose 41.8 % më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 në të cilën janë rimbursuar 16.5 miliard lekë, rimbursimet janë realizuar me 7.6 miliard lekë ose 45.9% më shumë.

2.1.3. Tatimi mbi Fitimin

Të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Fitimin, janë programuar 33.6 miliard lekë dhe aktualisht janë arkëtuar 35.7 miliard lekë, me një realizim prej 2.0 miliard lekë ose 6.1% më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, në të cilën u arkëtuan 28.4 miliard lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 7.3 miliard lekë ose 25.8% më shumë.

2.1.4. Tatimi mbi të Ardhurat Personale

Tatimi mbi të ardhurat personale është programuar 41.2 miliard lekë dhe është realizuar 43.8 miliard lekë, me një realizim prej 2.6 miliard lekë ose 6.3% më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, në të cilin u arkëtuan 37.1 miliard lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 6.7 miliard lekë ose 18.2% më shumë.

2.1.5. Taksat Kombëtare dhe Tarifa

Të ardhurat tatimore nga Taksat dhe Tarifa Kombëtare janë programuar në vlerën 14.2 miliard lekë dhe faktikisht janë arkëtuar 13.4 miliard lekë, me një mosrealizim 0.8 miliard lekë ose 5.5% më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, në të cilën u arkëtuan 11.9 miliard lekë, mbledhja e taksave është në rritje prej 1.5 miliard lekë ose 12.8 % më shumë.

2.1.6. Taksa e Qarkullimit Rrugor

Të ardhurat tatimore nga Taksat e Qarkullimit dhe Karburantit, të cilat janë programuar 20.5 miliard lekë, janë arkëtuar 19.7 miliard lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 0.8 miliard lekë ose 3.9 % më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, në të cilën u arkëtuan 17.0 miliard lekë, të ardhurat janë realizuar me rritje prej 2.7 miliard lekë ose 15.7 % më shumë.

Struktura e të Ardhurave Tatimore për periudhën 12 mujore 2021

Struktura e të ardhurave tatimore tregon se:

- TVSH-ja vazhdon të jetë kontribuesi kryesor në të hyrat publike me 32.3% të të ardhurave tatimore.
- Tatimi mbi të ardhurat personale përbën 26.0% të të ardhurave tatimore,
- Tatimi mbi fitimin zë 21.1 % të të ardhurave tatimore,
- Taksa e qarkullimit me 11.7% të të ardhurave tatimore.

Grafik 1. Struktura e të ardhurave




Tabela 1. Totali DPT 12 Mujori 2021

E M E R T I M I		FAKTET		PLANI	Diferenca Fakt Plan		Diferenca 2021- 2020	
		2020	2021	2020	+ ose -	Përqindje	+ ose -	Përqindje
	D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)	235,499,428	274,974,890	266,196,000	8,778,890	3.30%	39,475,462	16.76%
A	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arketim)	141,382,557	168,708,730	168,741,000	(32,270)	-0.02%	27,326,173	19.33%
1	TVSH (bruto)	46,174,825	54,461,470	58,310,000	(3,848,530)	-6.60%	8,286,645	17.95%
	- TVSH (neto)	29,663,293	30,359,348	41,310,000	(10,950,652)	-26.51%	696,055	2.35%
	- Rimbursimi i kryer	16,511,532	24,102,123	17,000,000	7,102,123	41.78%	7,590,590	45.97%
2	Tatim mbi Fitimin	28,358,795	35,664,554	33,631,000	2,033,554	6.05%	7,305,759	25.76%
3	Ardhura Personale	37,069,163	43,801,087	41,200,000	2,601,087	6.31%	6,731,924	18.16%
4	Taksat Nacionale	11,903,013	13,429,960	14,215,000	(785,040)	-5.52%	1,526,947	12.83%
5	Taksa e Qarkullimit Rrugor	17,033,877	19,706,202	20,500,000	(793,798)	-3.87%	2,672,325	15.69%
6	Lojrat e Fatit	726,963	1,534,803	885,000	649,803	73.42%	807,840	111.13%
7	Denimet Administrative	115,920	110,653	0	110,653		(5,267)	-4.54%
B	Te Ardhurat Tatimore (neto)	124,871,024	144,606,607	151,741,000	(7,134,393)	-4.70%	19,735,583	15.80%
C	Kontributet e Sigurimeve	94,116,872	106,266,160	97,455,000	8,811,160	9.04%	12,149,288	12.91%
D	D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)	218,987,896	250,872,767	249,196,000	1,676,767	0.67%	31,884,871	14.56%

Tabela 2. Të ardhurat e realizuara për vitin 2021 sipas DRT-ve (000 leke)

	Te ardhura Total Bruto			Te ardhura Tatimore Neto			Sigurime Shoqerore		
	Fakt	Plan	%	Fakt	Plan	%	Fakt	Plan	%
Berat	3,735,073	3,613,000	3.38%	3,494,116	3,253,000	7.41%	2,435,762	2,265,000	7.54%
Diber	3,277,178	2,967,500	10.44%	3,143,329	2,667,500	17.84%	2,050,228	1,920,000	6.78%
Durres	15,126,585	14,674,500	3.08%	13,749,228	13,504,500	1.81%	9,044,744	8,860,000	2.09%
Elbasan	7,235,649	7,114,500	1.70%	6,697,501	6,719,500	-0.33%	4,669,334	4,386,000	6.46%
Fier	8,609,302	8,275,500	4.03%	7,590,919	7,245,500	4.77%	5,440,188	5,090,000	6.88%
Gjirokaster	2,869,777	2,646,000	8.46%	2,770,663	2,526,000	9.69%	1,866,952	1,745,000	6.99%
Korce	5,660,515	5,597,000	1.13%	5,452,010	5,333,000	2.23%	3,782,958	3,630,000	4.21%
Kukes	2,091,313	1,858,000	12.56%	2,061,813	1,786,000	15.44%	1,381,241	1,210,000	14.15%
Lezhe	3,895,428	3,841,000	1.42%	3,747,946	3,751,000	-0.08%	2,530,355	2,415,000	4.78%
Sarande	2,055,293	1,983,500	3.62%	1,839,092	1,893,500	-2.87%	1,228,497	1,129,000	8.81%
Shkoder	6,103,451	5,784,000	5.52%	5,919,661	5,520,000	7.24%	4,180,992	3,920,000	6.66%
Tirane	104,445,669	99,229,000	5.26%	101,629,020	97,244,000	4.51%	39,161,245	34,880,000	12.27%
DTM	104,262,122	103,179,500	1.05%	87,610,979	92,679,500	-5.47%	24,989,307	22,790,000	9.65%
Vlore	5,607,534	5,433,000	3.21%	5,166,490	5,073,000	1.84%	3,504,356	3,215,000	9.00%
Total	274,974,890	266,196,000	3.30%	250,872,767	249,196,000	0.67%	106,266,160	97,455,000	9.04%

Tabela 3. Të ardhura nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (000 leke)

	Fakti TVSH		Plan TVSH		Ndryshimi %	
	neto	bruto	neto	bruto	neto	bruto
Berat	243,316	484,273	237,000	597,000	2.67%	-18.9%
Diber	409,577	543,426	86,000	386,000	376.25%	40.8%
Durres	865,675	2,243,032	1,138,000	2,308,000	-23.93%	-2.8%
Elbasan	435,118	973,266	741,000	1,136,000	-41.28%	-14.3%
Fier	200,493	1,218,876	362,000	1,392,000	-44.62%	-12.4%
Gjirokaster	274,514	373,628	252,000	372,000	8.93%	0.4%
Korce	466,040	674,545	560,000	824,000	-16.78%	-18.1%
Kukes	265,168	294,668	234,000	306,000	13.32%	-3.7%
Lezhe	365,657	513,140	579,000	669,000	-36.85%	-23.3%
Sarande	178,689	394,890	302,000	392,000	-40.83%	0.7%
Shkoder	425,796	609,586	445,000	709,000	-4.32%	-14.0%
Tirane	13,780,973	16,597,622	15,475,000	17,460,000	-10.95%	-4.9%
DTM	12,117,239	28,768,382	20,378,000	30,878,000	-40.54%	-6.8%
Vlore	331,092	772,136	521,000	881,000	-36.45%	-12.4%
Totali	30,359,348	54,461,470	41,310,000	58,310,000	-26.51%	-6.6%

Tabela 4. Te ardhura nga Tatimi mbi Fitimin (000 leke)

Tatimi mbi fitimin			
	Fakt	Plan	%
Berat	298,862	275,500	8.48%
Diber	192,995	204,000	-5.39%
Durres	1,817,872	1,624,000	11.94%
Elbasan	573,493	539,000	6.40%
Fier	825,628	799,000	3.33%
Gjirokaster	194,428	152,000	27.91%
Korce	379,379	419,000	-9.46%
Kukes	97,194	124,000	-21.62%
Lezhe	357,496	316,500	12.95%
Sarande	191,083	233,000	-17.99%
Shkoder	403,123	387,000	4.17%
Tirane	8,840,459	7,063,500	25.16%
DTM	20,984,402	20,961,000	0.11%
Vlore	508,140	533,500	-4.75%
Totali	35,664,554	33,631,000	6.05%

Tabela 5. Te ardhura nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (000 leke)

	Fakt	Plan	%
Berat	467,945	391,500	19.53%
Diber	450,505	376,500	19.66%
Durres	1,918,129	1,758,500	9.08%
Elbasan	964,951	954,500	1.09%
Fier	1,070,331	934,500	14.54%
Gjirokaster	405,778	351,000	15.61%
Korce	770,698	653,500	17.93%
Kukes	306,445	212,000	44.55%
Lezhe	465,579	411,500	13.14%
Sarande	225,941	211,500	6.83%
Shkoder	861,451	733,000	17.52%
Tirane	14,406,156	14,188,000	1.54%
DTM	20,719,167	19,295,500	7.38%
Vlore	768,011	728,500	5.42%
Totali	43,801,087	41,200,000	6.31%

Tabela 6. Krahاسimi TAP sipas zerave (000 leke)

		FAKT	FAKT	Diferenca 2021-2020	
		2021	2020	+ ose -	Pergindje
	Tatimi mbi te ardhurat personale	43,801,087	37,069,156	6,731,931	18.2%
1	Tatimi mbi page nga listepagesa	25,347,418	21,904,012	3,443,406	15.7%
1,1	Nga te punesuarit e Sektorit Publik	9,820,355	8,441,669	1,378,687	16.3%
1,2	Nga te punesuarit e Sektorit Privat	15,527,063	13,462,344	2,064,719	15.3%
2	Tatim mbi te Ardhurat nga Interesat	1,972,711	2,148,667	(175,955)	-8.2%
3	Tatim mbi te Ardhurat nga Qerate	4,275,528	3,829,061	446,467	11.7%
4	Tatim mbi Fituesit e Lodrave te Fatit	55,164	41,954	13,210	31.5%
5	Tatim mbi A.Personale Biznesi Vogel me xhiro 2-8 mln leke	3,341	1,984	1,357	68.4%
6	Te tjera Tatime mbi te Ardhurat ne Burim	2,624,279	2,399,163	225,116	9.4%
7	Tatimi mbi te ardhurat nga Dividentet dhe Aksionet	3,637,805	2,320,642	1,317,163	56.8%
8	Tatim mbi te Drejten e Autorit dhe Pronesise Intelektuale	262,711	231,927	30,784	13.3%
9	Tatimi mbi Deklaraten Individuale Vietore te te ardhurave	997,206	502,321	494,886	98.5%
10	Tatim, shitja e pasurise se naluaiteshme	4,612,652	3,661,371	951,281	26.0%
11	Tatim, trashegimia dhe dhurimi	12,272	28,055	(15,783)	-56.3%

Tabela 7. Të ardhura nga Taksat Kombëtare dhe Tarifa (000 leke)

	Fakt	Plan	%
Berat	45,802	84,000	-45.47%
Diber	37,726	81,000	-53.43%
Durres	92,909	124,000	-25.07%
Elbasan	49,290	99,000	-50.21%
Fier	42,447	60,000	-29.25%
Gjirokaster	24,307	26,000	-6.51%
Korce	47,261	70,500	-32.96%
Kukes	9,930	6,000	65.50%
Lezhe	25,280	29,000	-12.83%
Sarande	11,842	18,000	-34.21%
Shkoder	38,526	35,000	10.07%
Tirane	5,606,057	5,737,500	-2.29%
DTM	7,350,120	7,770,000	-5.40%
Vlore	48,463	75,000	-35.38%
Totali	13,429,960	14,215,000	-5.52%

Tabela 8. Taksat Kombëtare dhe Tarifat sipas llojeve (përfshirë Tarifa Buxhetore)

Struk.	Lloji i te Ardhurave	FAKTET		Diferenca FAKT 21-20	
		2020	2021	+ ose -	Perqindje
A=B+C	TAKSAT dhe TARIFA NACIONALE	11,903,013	13,429,960	1,526,947	12.83%
B	<i>Tarifa Kombetare</i>	777,411	917,555	140,143	18.03%
C	Taksa Kombetare	11,125,602	12,512,406	1,386,804	12.46%
	<i>Tarifa "BUXHETORE"</i>	3,037,772	3,826,206	788,434	25.95%
1	8.Tarife sherbimi per Qarkullimin e	62,273	64,069	1,796	2.88%
2	12.Tarife per rregjistrimin e Lojrave te Fatit ,	34,448	130,140	95,691	277.78%
3	5. Tarife sherbimi per licensat	14,743	13,350	(1,392)	-9.44%
4	2. Tarife sherbimi per perdorimin e aparateve televizive	1,238,289	1,265,225	26,936	2.18%
5	6. Tarife sherbimi per sherbimet e radiokomunikacionit	474,567	466,347	(8,220)	-1.7%
6	Takse nacionale per lejen e ushtrimit te	21,991	23,414	1,423	6.5%
7	Takse nacionale e karbonit per benzinen,	2,295,533	2,935,722	640,189	27.89%
8	Takse nacionale per ambalazhet plastike te	1,998,475	2,185,032	186,556	9.33%
9	Takse mbi te drejten e perdorimit te truallit	23,642	960	(22,683)	-95.94%
10	Taksë mbi Primet e shkruara	1,270,311	1,453,885	183,574	14.45%
11	Taksa per regjistrim fillestar per automjete	127,896	153,343	25,447	19.90%
12	Taksa e pervitshme per automjetet luksoze	265,744	247,772	(17,971)	-6.76%
13	Takse per automjetet e perdorura te	3,915,927	4,437,223	521,296	13.31%
14	9.Tarife sherbimi per kalimin e kufirit me	803,842	1,431,332	627,490	78.06%
15	Taksa portuale	370	662	293	79.13%
16	Taksa e Akteve dhe e Pulles	161,857	206,529	44,672	27.60%
17	Taksa e rentes minerare	442,319	864,641	422,323	95.48%
18	3 .Tarife per Sherbimet Konsullore	241,231	350,921	109,689	45.47%
19	1.Tarife Per paisjen me Deshmi Aftesie per	279,842	312,381	32,539	11.63%
20	13. Tarife per Regjitrin ne arsimin e Larte	145,319	143,300	(2,019)	-1.39%
21	7. Tarifa per pasaporte lundrimi te	2,428	1,438	(990)	-40.79%
22	4. Tarifa per aktet administrative	517,275	563,376	46,101	8.91%
25	Tarife , gjoba, interesa	925	1,882	957	103.49%
26	Taksa te tjera , gjoba, interesa	601,538	3,223	(598,315)	-99.46%
	Taksa e qarkullimit	17,033,877	19,706,202	2,672,325	15.69%
A+C	Gjithesej Taksa , tarifa nacionale + tarifa	14,940,785	17,256,166	2,315,381	15.50%

Tabela 9. Të ardhura nga Taksa e Qarkurllimit Rrugor (000 leke)

	Fakt	Plan	%
Berat	0	0	0.00%
Diber	0	0	0.00%
Durres	0	0	0.00%
Elbasan	0	0	0.00%
Fier	0	0	#DIV/0!
Gjirokaster	0	0	0.00%
Korce	0	0	0.00%
Kukes	0	0	0.00%
Lezhe	0	0	0.00%
Sarande	0	0	0.00%
Shkoder	0	0	0.00%
Tirane	19,706,202	19,900,000	-1%
DTM	0	600,000	-100%
Vlore	0	0	0%
Totali	19,706,202	20,500,000	-3.87%

Tabela 10. Të ardhurat nga sigurimet shoqërore & shëndetësore

	Fakt	Plan	%
Berat	2,435,762	2,265,000	7.54%
Diber	2,050,228	1,920,000	6.78%
Durres	9,044,744	8,860,000	2.09%
Elbasan	4,669,334	4,386,000	6.46%
Fier	5,440,188	5,090,000	6.88%
Gjirokaster	1,866,952	1,745,000	6.99%
Korce	3,782,958	3,630,000	4.21%
Kukes	1,381,241	1,210,000	14.15%
Lezhe	2,530,355	2,415,000	4.78%
Sarande	1,228,497	1,129,000	8.81%
Shkoder	4,180,992	3,920,000	6.66%
Tirane	39,161,245	34,880,000	12.27%
DTM	24,989,307	22,790,000	9.65%
Vlore	3,504,356	3,215,000	9.00%
Totali	106,266,160	97,455,000	9.04%

3. Sektori i Kontabilitetit dhe Pagesës


Sektori i Kontabilitetit dhe Pageses monitoron funksionimin e sistemit të pagesave të detyrimeve tatimore dhe kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, me qëllim lehtësimin e procedurave të pagesës nga tatimpaguesit, lehtësimin e punës me bankat e nivelit të dytë për përgatitjen e informacionit në lidhje me këto pagesa dhe përmiresimin e përpunimit të të dhënave të pagesave për qëllime të administratës tatimore.


Sektori i Kontabiliteti dhe Pageses ne perputhje me Objektivin e Planit Strategjik “Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare”– duke ofruar shërbime cilësore dhe duke ndikuar në reduktimin e barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore” ka mundësuar arritjen e rezultateve si me poshte”

1. Raportimin në kohë sa më të shpejtë i pagesave të arkëtuara në buxhetin e shtetit pranë Drejtorise se Kontabilitetit dhe Analizes si dhe strukturave drejtuese ne DPT.
2. Identifikimin i pagesave pezull dhe sistemimi i tyre në llogarinë e duhur të tatimpaguesit.

Gjate vitit 2021, ky sektor ka ndjekur, pergatitur dhe raportuar ne kohe dhe me sakte si informacionin mbi pagesat e kryera ne bankat e nivelit te dyte dhe ne thesar lidhur me te ardhurat tatimore dhe kontributet e detyrueshme te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore. Puna e kesaj drejtorie gjate vitit 2021 eshte fokusuar ne:

- Marrjen dhe Krahasimin e ekstraktit bankar me të dhënat e ardhura elektronikisht nga sistemi i thesarit.
- Komunikimin me Drejtorise e Teknologjisë se Informacionit dhe Komunikimit ne funksion te mbarevajtjes se punes dhe saktesis se informacionit. Numri i komunikimeve elektronike per zgjidhjen e problematikave te konstatuara gjate vitit 2021 ka qene rreth 18 dhe 20 komunikime per mosrakordimin e raporteve te pageseva ne e-Tax Helpdesk.
- Sistemimin e pagesave pezull në bazë të Akt-Marrëveshjes mes Ministrisë së Financave dhe bankave të nivelit të dytë, duke komunikuar në mënyrë permanente me bankat e nivelit të dytë dhe me tatimpaguesit. Më saktësisht, janë sistemuar 998 raste për vitin 2021. Me poshte paraqiten me grafik keto sisteme sipas muajve dhe sipas bankave.





Përgatitjen e raporteve ditore, mujore dhe progresive të të ardhurave të tatimore dhe kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe për çdo drejtori rajonale tatimore pas rakordimit të të ardhurave me bankat e nivelit të dytë dhe degën e thesarit si dhe vënja e këtyre raporteve në dispozicion të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Analizës dhe

strukturave drejtuese ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve. Gjate vitit 2021 jane kryer 15 komunikime elektronike me bankat e nivelit te dyte dhe me tatimpaguesit per problematika te ndryshme.

- Komunikimin e vazhdueshem me bankat e nivelit të dytë në zbatim të Akt- Marrëveshjes për të gjitha sqarimet për rastet e sistemimeve të pagesave që nuk mund të identifikohen nga Administrata Tatimore apo të ndonjë problemi të lindur gjatë zbatimit të kësaj akt marrëveshje me bankat e nivelit të dytë.

III. SHËRBIMI I TATIMPAGUESVE

Gjatë vitit 2021, puna e Drejtorisë të Shërbimit të Tatimpaguesve, është përqendruar në konsolidimin, rritjen e nivelit dhe lehtësimin e shërbimit ndaj tatimpaguesve. Kjo është arritur duke ndjekur realizimin e detyrave dhe objektivave të përcaktuara, në Planin Operacional të vitit 2021, si dhe detyrave të realizuara në funksion të reformave të DPT-se.

Drejtoria e Shërbimit për Tatimpaguesit është përgjegjëse, për sigurimin e ofrimit të shërbimit cilësor dhe asistencës për të gjithë tatimpaguesit, për menaxhimin e regjistrimit të tatimpaguesve përfshirë azhurnimet e tij, me qëllim përmbushjen vullnetare të detyrimeve ligjore.

I - Asistenca dhe shërbimi për tatimpaguesit

Spektori i Asistencës dhe Shërbimit për Tatimpaguesit, si pjesë e Drejtorisë së Shërbimit për tatimpaguesit në DPT, për vitin 2021 është fokusuar në zbatimin e detyrave dhe aktiviteteve sipas Planit Operacional 2021, me qëllim përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen tatimpaguesve, me qëllim reduktimin e barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore, si dhe detyrave të ngarkuara në funksion të reformave të ndërmarra nga DPT.

Objektivat e këtij Spektori për vitin 2021 ishin:

- Rritja e nivelit të informimit dhe ndërgjegjësimin të tatimpaguesve për në funksion të përmbushjes së detyrimeve të tyre tatimore
- Përfshirja e shërbimeve të reja online

1. Shërbim dhe asistencë cilësore për tatimpaguesit

1. Gjatë vitit 2021, sportelet e Shërbimit kanë pritur rreth 217.415 vizitorë, të cilët janë tatimpagues apo individë, të cilëve iu është ofruar shërbim dhe asistencë në lidhje me kërkesat e tyre për informacion, në lidhje me ndryshimet e Legjislacionit tatimor, për kuptimin e përgjegjesive tatimore, deklarimit elektronik, pajisjes me vërtetime nëpërmjet portalit e-albania etj.

Numri i njoftimeve i dërguar tatimpaguesve me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitien e korrektimit vullnetar.	403 485
Numri i takimeve të mbajtura me tatimpaguesit me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitien e korrektimit vullnetar.	117
Numri total i vizitave këshilluese të përfunduara	59 024
Numri i seminareve edukues të realizuar	1349
Numri total i taksapaguesve i asistuar (ballë për ballë)	217 415

Shërbimi për tatimpaguesit është orientuar drejt përmirësimit të shërbimeve dhe rritjes së cilësisë së tyre. Gjatë vitit 2021 janë shtuar edhe 4 shërbime të reja, që ofrohen automatikisht për tatimpaguesit nëpërmjet portalit e-Albania, përveç 11 shërbimeve që ofrohen elektronikisht prej Tetor 2017. Keto 15 shërbime përbejnë 99% të totalit të shërbimeve, krahasuar me ato që ofrohen në sportele.

Vertetime të leshuara në sportelet e shërbimit 2021

Vert. per pag, e detyr. Tatimore. (FORM. 4)	1346
Vert. xhir.per 3 vitet e fund,per tender.(FORM.6)	138
Vert. per xhir e 3 vit, te fundit. (FORM. 3)	442
Vert,per kontrib e sigurimet. (FORM.E-SIG 02/A)	529
Vert.per num,e te siguruarve ne shoq.per tender. E-sig 01-A	94
Vert.per dispon,e mjeteve te transp. (FORM.8)	13
Vert.per lejim ose zbllokim importesh (FORM. 1,2,3).	0
Vert.per marrjen e lejes se shfryt.ne ndertim (FORM.2)	2
Vert.per efekt regjistr.e pasur,se paluajtsh,ne ZRPP(FORM.4)	0
Vert.per regjistr.e invest ne ndertim (FORM.1)	0
Vert.per kontribut.individ. te punonjes. (FORM. E-sig 03/A	2466
Vertetime per individe qe nuk kane aktivitet privat , etj.	11844
FORMULAR TE DYFISHTE	507
Vertetim statusi	506
Vertetim per pergjegjesite tatimore	179
Totali	18,066

Aplikime për vërtetime dhe pagesa të kryera online nga portali e-Albania 2021

Certifikatë Rezidence Tatimore	24469
Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi (eSig25)	43477
Vërtetim për individ të paregjistruar	37803
Vërtetim për pagim detyrimesh	13534
Vërtetim për pagimin e kontributeve nga subjekti	20115
Vërtetim për pagimin e kontributeve për individin	250995
Vërtetim për përgjegjësitë tatimore	8200
Vërtetim për posedim mjeti	1079
Vërtetim për regjistrim të investitorit	133
Vërtetim statusi (aktiv, pasiv përfshirë datën)	8980
Vërtetim xhiro për 3 vitet e fundit	4770
Deklarimi dhe pagesa e kontributeve nga punëdhënësit	300440
Detyrime globale	16496
Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	46507
Renta minerare	474
Taksat kombëtare	3201
Tarifat kombëtare	3543
Tatim fitimi	7428
Tatim i lojrave të fatit	800
Tatim i mbajtur në burim	8797
Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	5122
Tatim mbi të ardhurat nga punësimi	2875
Tatim mbi të ardhurat personale	3278
Tatim mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël	3326
Tatim mbi vlerën e shtuar	5492
Rivendosje fjalëkalimi për tatimpagues të regjistruar	510
Aplikim për certifikatë rezidence për individët	1367
Kërkesë për regjistrimin e një subjekti tatimpagues	1479
Njoftim i ndryshimeve në regjistrim	2625
Totali	827,315

2. Informimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi i tatimpaguesve:

- Plan komunikimi për informimin e individëve, subjekt i deklarimit të DIVA 2020. Janë realizuar më shumë se 30,000 thirrje telefonike, komunikime me email, janë dërguar letra për individët mosdeklarues në vendin e ushtrimit të aktivitetit të punëdhënësit.
- Plan komunikimi për Paketën Fiskale, i cili përfshiu: takime informuese me subjektet e interesuara; njoftime në web dhe FB, kronika dhe intervista në media; si dhe me shume se 25,402 vizita informuese në vendet e ushtrimit të aktivitetit të subjekteve.
- 31, 471 tatimpagues dhe 3,433 kontabilistë të trajnuar për procesin e fiskalizimit.
- 36,559 letra të dërguara tatimpaguesve me qëllim informimin për detyrimet që ju lindin për zbatimin e Ligjit nr. 87/2019 “Për Faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” i ndryshuar
- Përditësimi periodik i legjislacionit tatimor të publikuar ne faqen e internetit.
- 8,655 Vizita informuese tek tatimpaguesit e rinj;
- 217 415 tatimpagues të asistuar (ballë për ballë);

II. Sektori I Thirrjeve dhe struktura organizative

1.Komunikimi nepermjet sistemit elektronik te tatimpaguesve

❖ Komunikim me thirrje hyrëse	26,743
❖ Komunikim me thirrje dalëse	113,218
❖ Komunikim Fiskalizimi	7,274
Thirrje gjithsej viti 2021	147,562
Thirrje gjithsej viti 2020	137, 023
❖ Komunikimi ne Live Chat	3,590
❖ E-maile të ndryshme	98
Komunikime gjithsej	140,711

Ne vitin jane realizuar 137,023 thirrje , ndersa ne vitin 2021 jane realizuar **147,562 thirje.**

Krahasuar me vitin 2020 jane kryer respektivisht 7.7 per qind me teper thirrje me tatimpaguesit duke realizuar zotimet e parashikuara ne objektivat e DSHT.

2. Tematika e komunikimeve

Gjate vitit 2021 jane realizuar komunikime me tematika te ndryshme duke bashkepunuar me Drejtorite ne DPT. Disa lloje komunikimesh:

1. Rritjen e komunikimeve me tatimpaguesit debitore
2. Komunikime per fiskalizimin me te gjitha nivelet e bizneseve

3. Zgjerimi i komunikimeve qe lidhen me fiskalizimin dhe rritja e besueshmërisë së publikut tatimpagues.
4. Komunikimi per informimin e tatimpaguesve qe regjistrohen per here te pare ne Administraten Tatimore, lidhur me detyrimet ligjore per pagesen e tatimeve.

3. Pengesa ne kryerjen e funksioneve

Gjate vitit 2021 jane shfaqur disa pengesa qe kane ndikuar ne kryerjen e detyrave funksionale:

1. Komunikimi me live-chat nuk ka funksionuar periodikisht dhe ende eshte jashte funksioni.
2. Baza material ne numer dhe cilesi eshte me cilesi te dobet dhe e pamjaftueshme per te kryer komunikime. Nga 10 kufje ne inventar jane ne gjendje pune 4 cope.
3. Kompjuterat nuk jane te gjitha ne gjendje pune dhe nga 8 poste per pune jane ne gjendje pune vetem 4 poste.
4. Ambjenti eshte i papershtatshem dhe nuk garanton distancen sociale qe kerkohet per mbrojtjen nga Covid-19.

III- Sektori i Regjistrimit ne DPT eshte perqendruar ne keto drejtime kryesore:

1-Regjistrimi dhe Azhornimi i Regjistrit Kombetar te tatimpaguesve.

Gjate vitit 2021, (Janar- 31 Dhjetor) sipas te dhenave te transmetuara nga QKB dhe atyre te ngarkuara ne sistem nga veprimet e kryera nga DRT-te ne rrethe per tatimpaguesit qe regjistrohen nga ana e tyre, rezulton se:

Numri i tatimpaguesve aktive, (qe kane nje pergjegjesi tatimore) ne Regjistrin Kombetar ne fund te vitit 2021, sipas te dhenave te nxjerra nga raportet e SIT, rezulton: **119,324** tatimpagues gjithesej. Ne kete shifer nuk jane perfshire **63,282** Fermere. Nga shifra gjithesej e aktiveve jane te regjistruara ne pergjegjesine tatimore TVSH 28,945 tatimpagues, nga te cilet 8,814 jane Tp. te biznesit te vogel.

Realizimi i funksionit te regjistrimit te subjekteve te reja, eshte kryer nepermjet:

- Regjistrimeve ne QKB-ne nepermjet regjistrimeve te bizneseve te reja dhe
- mbikqyrjes se regjistrimit te tatimpaguesve te kategorise OJF-ve , Ambulante, Fermere etj..., qe kryen nga Drejtorite Rajonale.

Vlen per t'u theksuar se procesi i transmetimit dhe procesimit te te dhenave per regjistrimet e reja nga QKB ne DPT per vitin 2021 ka ecur normalisht dhe nuk jane paraqitur probleme.

2-Transferimi i tatimpaguesve nga nje DRT ne nje DRT tjeter

Transferimi i tatimpaguesve nga nje drejtori rajonale tatimore ne nje tjeter, jane veprime qe kryhen nga Administrata Tatimore ne baze te ndryshimeve te selise qe kane kryer tatimpaguesit ne QKB gjate nje viti. Ky transferim iniciohet mbas ndryshimit qe ben tatimpaguesi prane QKB-se. Te dhenat nxirren nga Sistemi per te dhenat e transmetuara nga QKB dhe Sektori i Regjistrimit pasi kryhen veprimet perkatese per ndryshimin e DRT ne Sistem njofton çdo DRT per ndryshimet e ndodhura.

Gjate vitit 2021 jane transferuar (ndryshuar DRT ne Sistem) 678 tatimpagues dhe ky informacion publikohet e perditesohet ne faqen tone te intranetit ne ndihme dhe te Drejtorive te tjera ne DPT.

Gjate vitit 2021 nuk ka patur levizje te tatimpaguesve nga DRT ne NJTM dhe anasjelltas te cilat behen per nevoja administrimi me te mire me urdher dhe rregullore te Drejtorit te Pergjithshem te Tatimeve.

Realizimi i transferimeve te kryera nga ndryshimi i selise se tatimpaguesit ne QKB dhe i levizjeve te tatimpaguesve (Hyrje-daljeve) nga NJTM jep numrin e tatimpaguesve gjithesej, qe ka nje DRT ne nje periudhe te caktuar.

3-Kalimi ne pasiv i tatimpaguesve

Kalimi ne pasiv i tatimpaguesve per vitin 2021 ka qene nje process qe pothuajse kryhet ne menyre automatike ne sistemin informatik dhe ne pak raste nga DRT ne rrethe. Nga te dhenat qe administrojme ne fund te vitit 2021 rezultojne te regjistruar ne regjistrin pasiv (progresive) gjithesej 136,316 tatimpagues, nga te cilet kane kaluar gjate ketij viti 11,496 tatimpagues.

Perditesimi dhe azhurnimi i regjistrit Pasiv behet nepermjet – kalimit ne pasiv nga veprimet e pezullimin te aktivitetit qe kryhen tatimpaguesi ne QKB, dhe kalimi automatik nga sistemi edhe i tatimpaguesve qe kane periudhe mosdeklarimi dhe deklarimin pa veprimtari per me shume se 12 periudha mujore te njepasnjeshme dhe tashme kjo procedure per ekzekutimin e procesit te kalimit automatik ne Pasiv nga Sistemi, funksionon rregullisht per çdo fund muaji.

Lista e tatimpaguesve pasive e perditesuar eshte e publikuar ne faqen e web-it te DPT, e cila sherben per verifikim dhe konsultim dhe nga ana e tatimpaguesve per qellime te transaksioneve te tyre.

Theksojme se procedurat e kalimit ne pasiv tashme jane me te thjeshtuara duke bere te mundur pastrimin e regjistrit nga tatimpaguesit jo aktive dhe perditesimin e te dhenave ne Regjistrin e Tatimpaguesve.

Drejtoria e Sherbimit ne DPT, vazhdimisht bashkepunon me QKB dhe Palen Furnitore per problemet qe mund te shfaqen per kalimin e tatimpaguesve ne statusin pasiv, si dhe orienton DRT ne rrethe per zgjidhjen e problemeve, dhe bazuar veprimeve nga QKB sqaron tatimpaguesit per statusin e tij.

Pervec kalimeve ne statusin pasiv, ne zhvillimet aktuale te bera ne Sistem eshte e mundur riaktivizimi autokatik i Tp. nga statusi Pezulluar qe ai ka ne QKB ne Aktin ne sistemin tatimor. Konkretisht gjate vitit 2021 jane kryer riaktivizime automatike te ardhura nga QKB per 4,525 tatimpagues. Pervec nga QKB ne 2021 jane riaktivizuar manualisht me ceshtje dhe nga DRT 622 tatimpagues nga veprimet e kryera nga DRT perkatese.

4-Azhornimi i ndryshimeve ne regjistrim, qe behen ne QKB

Çdo ndryshim mbi te dhenat e regjistrimit qe kryejne subjektet apo tatimpaguesit ne QKB apo ne DRT (per sa eshte e percaktuar ne ligj dhe udhezimet perkatese) pasqyrohet ne Sistem.

Procesi i azhornimit te ndryshimeve ne regjistrim (transmetimi nga QKB- ne DPT) qe bejne tatimpaguesit ne QKB, dhe qe jane pjese e ndryshimeve te te dhenave ne regjistrin tregtar, kryhet normalisht.

Ne kete azhornim apo perditesimin e ndryshimeve qe ka bere tatimpaguesi ne QKB per vitin 2021 ka ndikuar zbatimi i Marreveshjes se bashkepunimit si dhe protokollit elektronik te shkembimit te te dhenave midis dy institucioneve DPT-QKB (firmosur ne shtator 2019).

Konkretisht per kete vit jane permiresuar te dhena mbi:

1-Marrjen e te dhenave dhe informacionit nga QKB ne menyre elektronike, mbi shoqerite qe likujdohen, bashkohen, ndahen dhe transformohen.

2- Permiresimi dhe plotesimi i informacionit per personat e lidhur brenda nje shoqerie apo personi juridik, per vendosjen e ID

3- Rregullimi i gabimeve dhe perditesimi i te dhenave te regjistrimit te tatimpaguesve qe administrohen dhe regjistrohen vetem ne AT, ne funksion te ecurise se procesit te Fiskalizimit.

Keto te dhena shfaqen ne sistem dhe ndihmojne perdoruesit per te marre nje informacion me te shpejte dhe me te sakte per qellim te punes se tyre gjate verifikimeve dhe kontrolleve ne kohen e duhur.

Ne punen e perditeshme sa here qe konstatohen probleme nga sektoret e sherbimit ne DRT, ato behen prezent ne Drejtorine e Sherbimit ne DPT per zgjidhje me Palen Furniture qe miremban Sistemin, per te dhene zgjidhje praktike çdo rasti te konstatuar.

5- Çregjistrimi i tatimpaguesve ne sistem

Gjendja e tatimpaguesve te çregjistruar progresive ne Sistemin e Ri Tatimor ne fund te 2021 rezulton 64,237 tatimpagues.

Per vitin 2021 u finalizuan te çregjistruar ne Regjistrin Kombetar te DPT 2,724 tatimpagues te cilet permbushen dhe detyrimet ligjore.

Procesi i çregjistrimit te tatimpaguesit finalizohet ne DRT perkatese. Çertifikatat e çregjistrimit (kopje) te leshuara nga QKB aktualisht dergohen direkt ne DRT perkatese ne baze te marrveshjes qe kemi rene dakort me QKB, pasi aty do te kryhen dhe veprimet konkrete per çregjistrimin e tatimpaguesit edhe nga Regjistri i tatimpaguesve te DRT.

Edhe ne vitin 2021 çregjistrimi i tatimpaguesve bazuar nga problemet e derguara nga DRT ne rrethe ne disa raste ka veshtiresi, pasi finalizimi i çregjistrimit nuk mund te realizohet nga punonjesit tane ne DRT.

Kjo vjen edhe si rezultat;

-I mospermbushjes se kushteve ligjore nga ana e tatimpaguesve duke mos paguar te gjitha detyrimet dhe dorezuar te gjitha deklaratat tatimore.

- I mosveprimit te punonjesve te Kontrollit per te vleresuar deklaratat dhe llogarine perkatese te Tatimpaguesit, dhe i mosmiratimit te çregjistrimit nga ana e tyre, per te cilat pengojne çregjistrimin e tij.

IV. PERFORMANCA TEKNIKO-LIGJORE

HYRJE

Objekti kryesor i punës së Drejtorisë Teknike dhe Ligjore (DTL) siç është përcaktuar edhe në Rregulloren e Administratës Tatimore Qendrore është garantimi dhe zbatimi me paanshmëri i ligjit në mënyrë të tillë që çdo akt administrativ dhe dokument zyrtar që del nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të jetë i mbështetur në Legjislacionin Tatimor dhe ligjet e tjera të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

Në kuadër të realizimit të detyrave dhe planit strategjik 2017-2021, DTL ka synuar t'i përmbahet vizionit për ofrimin e një Administrate Tatimore moderne dhe efikase në shërbim të tatimpaguesve, për të garantuar një nivel të lartë të transparencës dhe modernizimit të shërbimeve në zbatim të legjislacionit tatimor.

Organizimi i Drejtorisë Teknike dhe Ligjore

Drejtoria Teknike dhe Ligjore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është e organizuar dhe funksionon si vijon:

- Sektori i Çështjeve Ligjore;
- Sektori i TVSH-së dhe taksave të tjera;
- Sektori i Taksave Direkte.

SEKTORI I ÇËSHTJEVE LIGJORE

Për periudhën Janar-Dhjetor 2021 ky sektor ka ofruar shërbim ligjor dhe konsulencë e asistencë juridike për Drejtoritë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve; Drejtoritë Rajonale Tatimore dhe për tatimpagues të ndryshëm, nëpërmjet:

- ✓ Dhënies së opinionit ligjor për çështje dhe problematika të hasura në praktikë, për të cilat është kërkuar mendim nga strukturat në DPT apo Drejtoritë Rajonale Tatimore. Sektori i Çështjeve Ligjore ka bashkëpunuar me drejtoritë përkatëse për dhënien e një informacioni të bazuar në ligj, të qartë dhe të kuptueshëm, në mënyrë që të garantohet asistencë teknike dhe ligjore për tatimpaguesin.
 - Janë dërguar mbi 60 (gjashtëdhjetë) opinione ligjore ndaj strukturave të administratës tatimore lidhur me çështje specifike të cilat janë analizuar rast pas rasti.

- Janë trajtuar mbi 1000 shkresa.

- ✓ Janë përcjellë zyrtarisht në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë 5 (pesë) propozime për ndryshime në legjislacionin tatimor në fuqi, që prekin pothuajse të gjithë kuadrin ligjor të ligjeve tatimore si dhe duke i dhënë një fokus të veçantë procesit të fiskalizimit, konkretisht:
 - Propozim për ndryshim në VKM nr.613 datë 29.07.2020 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 4/2020 “Për shkëmbimin automatik të llogarive financiare”;
 - Propozim për ndryshim në VKM 953/2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” si dhe relacionin përkatës;
 - Propozim për ndryshim në VKM nr.220 datë 12.03.2020 “Për përcaktimin e kategorisë së tatimpaguesve dhe të kriterëve të përdorimit të procedurës së thjeshtëzuar të fiskalizimit” të ndryshuar;
 - Propozim për ndryshim në VKM nr.239 datë 20.03.2020 “Për kërkesat teknike dhe funksionale të zgjidhjes software-ike për procedurën e faturimit dhe të fiskalizimit si dhe procedurën e kriteret për regjistrimin e prodhuesve e të mirëmbajtësve të zgjidhjeve softëare-ike”;
 - Projekt-vendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 9920 datë 19.5.2008 Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- ✓ Janë përgatitur 2 Buletine të Vendimeve Gjyqësore, përkatësisht për periudhat Janar - Qershor 2021 dhe Korrik- Dhjetor 2021.

Proceset gjyqësore:

Specialistët e Sektorit të Çështjeve Ligjore në DPT përfaqësojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në të gjitha konfliktet gjyqësore ku ajo është palë ndërgjyqëse. Për vitin 2021 specialistët/juristët e Drejtorisë Teknike dhe Ligjore kanë përfaqësuar DPT- në të gjitha konfliktet gjyqësore të deleguara sipas rastit, me palë paditëse ish-punonjës të kontraktuar nga administrata tatimore, bazuar në dispozitat e Kodit të Punës apo nëpunës civilë të konfirmuar.

Janë marrë masat për të garantuar përfaqësimin në çdo proces gjyqësor. DPT është përfaqësuar profesionalisht në 243 çështje të lidhura me marrëdhënien e punës, si më poshtë:

- i. Në Gjykatat Civile gjatë vitit 2021 janë gjykuar 147 çështje gjyqësore me palë paditëse punonjës dhe ish-punonjës të kontraktuar me kontratë punësimi nga Administrata Tatimore, për të cilat Gjykatat e Rrethit Gjyqësor kanë dalë me vendim për 44 çështje dhe Gjykatat e Apelit kanë dalë me vendim për 7 çështje, vijon gjykimi për 96 çështje.

- ii. Në Gjykatat Administrative gjatë vitit 2021 janë gjykuar 96 çështje gjyqësore, ku Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë kanë dalë me vendim për 25 çështje gjyqësore dhe Gjykata Administrative e Apelit ka dalë me vendim për 5 çështje, vijon gjykimi për 66 çështje.

Detyra të tjera të realizuara nga Sektori i Çështjeve Ligjore:

- ✓ Ka garantuar trajtimin e praktikave për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, konform legjislacionit në fuqi;
- ✓ Janë ndjekur dhe vlerësuar praktikat e ardhura në DPT nga Zyrat e Përmbartimit apo kërkesa individuale për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe ka përgatitur të gjitha praktikat e ardhura për trajtim si dhe përcjelljen për veprime të mëtejshme strukturave kompetente.
- ✓ Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional janë konkluduar:
 1. Marrëveshjes së Bashkëpunimit për përcaktimin e punonjësve të atashuar pranë njësisë speciale antikorupsion dhe antievazion”, midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Njësisë Speciale Antikorupsion dhe Antievazion.
 2. Ndryshimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;
 3. Marrëveshje Bashkëpunimi “Për Shkëmbimin e Informacionit midis dy Institucioneve në Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit” midis BKH dhe DPT.
- ✓ Pjesëmarrja në grupe pune të ndryshme të caktuara me urdhër të titullarit si:
 - Komisionet e Vlerësimit të Ofertave apo njësitë e Prokurimit për procedurat e prokurimeve të zhvilluara nga institucioni;
 - Komisionin e përhershëm të Certifikimit të zgjidhjeve software-ike;
 - Anëtarë në GNPIE në kapituj të ndryshëm.

SEKTORI I TVSH-SË DHE TAKSAVE TË TJERA

Sektori i TVSH-së dhe taksave të tjera ka trajtuar dhe asistuar me shpjegime dhe opinione teknike, duke iu përmbajtur dispozitave ligjore tatimore, strukturat e brendshme të Administratës Tatimore, po ashtu edhe një numër të konsiderueshëm çështjesh të ardhura për sqarime tekniko-ligjore në adresë të DPT-së. **Konkretisht Sektori TVSH-së ka trajtuar 574 shkresa,** duke siguruar një informacion të plotë, të kuptueshëm në kohë dhe të aksesueshëm në lidhje me përmbushjen tatimore.

- ✓ Janë përgatitur dhe përcjellë zyrtarisht në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë aktet si më poshtë:

- Udhëzimi Nr. 22, Datë 15.10.2021 “Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. 16, Datë 3.4.2020, “Për Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit”.
- VKM Nr. 415, Datë 8.7.2021”Për Rregullat e Aksesit të Subjekteve të Interesuara në bazën e të Dhënave të Regjistrit Qendror Të Llogarive Bankare”.
- Akt Normativ Nr. 36, Datë 24.12.2021 Për një Shtesë në Ligjin Nr. 9920, Datë 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
- ✓ Janë përgatitur 2 Buletine të Vendimeve Teknike për periudhat Janar - Qershor 2021 dhe Korrik-Dhjetor 2021.
- ✓ Janë dhënë opinione/sqarime/komente për çdo ndryshim ligjor që është propozuar lidhur me legjislacionin tatimor.
- ✓ Pjesëmarrja në grupe pune të ndryshme të caktuara me urdhër të titullarit.

1. SEKTORI I TAKSAVE DIREKTE

Sektori i Taksave Direkte, referuar Rregullores së Administratës Tatimore Qëndrore, si dhe akteve të brendshme të DPT-së, për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 ka trajtuar praktika me lëndë në përputhje me detyrat funksionale. Sipas protokollit të brendshëm sektorial, rezultojnë 2.743 (*dymijë e shtatëqind e dyzet e tre*) praktika të bëra hyrje për trajtim, klasifikuar sipas tabelës Nr.1.

Tabela.1. Hyrje _Praktika_per Trajtim_2021

Nr.	Lenda e Praktikes	Nr. Hyrje	%
1	Zbatim Marreveshje	1,317	48.01%
2	Plotesim Dokumentacioni	829	30.22%
3	Certifikate Rezidence	208	7.58%
4	Kerkese per interpretim ligjor	138	5.03%
5	Kerkese per kopje praktike arshiva D.P.T	94	3.43%
6	Kerkese per informacion nga subjektet	76	2.77%
7	Vertetim per TB&TAP&T.Divident	21	0.77%
8	Nenshkrim formular per te ardhura vjetore me burim në RSH	19	0.69%
9	Shkembim Informacioni me DRT-te	12	0.44%
10	Shkembim informacioni me institucionin MFE	16	0.58%
11	Kerkese per dublicat nga tatimpaguesit aplikues	6	0.22%
12	Shkembim informacioni me institucione publike	3	0.11%
13	Kerkese per takim nga subjektet	2	0.07%
14	Kerkese per paisje me autorizim sponsorizimi	2	0.07%
Grand Total		2,743	100%

Referuar, tabelës “*Hyrje_Praktika për Trajtim në 2021*”, praktikat me lëndë “*Zbatim Marrëveshje*” rezultojnë me volumin më të lartë, në peshë specifike ndaj totalit në masën **48%**, ndërsa praktikat me

lëndë “plotësim dokumentacioni për Zbatim Marrëveshje” rezultojnë në peshë specifike ndaj totalit të praktikave në masën **30%**.

Aplikimet për Çertifikatë Rezidence nga individë rezidentë, administrator me nënshtetësi të huaj, rezultojnë me një volum në masën 8% ndaj totalit, ndërsa kërkesat për interpretim ligjor, rezultojnë në masën 5% ndaj totalit, të tjera praktika sipas klasifikimit në tabelën, sa më sipër rezultojnë me një peshë në masën në masën 9% ndaj totalit.

Tabela Nr.2 Permbledhje e praktikave te trajtuara _v.2021

Nr.	Lenda e Praktikes	Nr. Hyrje	%	Nr.Trajtuar	%
1	Zbatim Marreveshje	1,317	48.01%	998	76%
2	Plotesim Dokumentacioni	829	30.22%	654	79%
3	Certifikate Residence	208	7.58%	194	93%
4	Kerkese per interpretim ligjor	138	5.03%	87	63%
5	Kerkese per kopje praktike arshiva D.P.T	94	3.43%	84	89%
6	Kerkese per informacion nga subjektet	76	2.77%	41	54%
7	Vertetim per TB&TAP&T.Divident	21	0.77%	18	86%
8	Nenshkrim formular per te ardhura vjetore me burim në RSH	19	0.69%	16	84%
9	Shkembim Informacioni me DRT-te	12	0.44%	7	58%
10	Shkembim informacioni me institucionin MFE	16	0.58%	16	100%
11	Kerkese per dublicat nga tatimpaguesit aplikues	6	0.22%	5	83%
12	Shkembim informacioni me institucione publike	3	0.11%	3	100%
13	Kerkese per takim nga subjektet	2	0.07%	2	100%
14	Kerkese per paisje me autorizim sponsorizimi	2	0.07%	2	100%
Grand Total		2,743	100%	2,127.00	78%

Paraqitja grafike e Tabeles Nr.2




Tabela nr.3 .Praktika te mbartura nga v.2020, trajtuar ne v.2021

Lenda	Nr.Trajtuar	%
Zbatim Marreveshje	241	64%
Plotesim Dokumentacioni	110	29%
Certifikate Rezidence	8	2%
Interpretim ligjor	8	2%
Te tjera	8	2%
Grand Total	375	100%

Sipas te dhenave tabelare dhe grafike, rezulton qe Sektori i Taksave Direkte per periudhen 2021 ka trajtuar ne total 2.502 praktika, nga te cilat 2.127 praktika te vitit 2021 dhe 375 praktika te bera hyrje ne vitin 2020, ku referuar numrit mesatarisht vjetor te praktikave te bera hyrje ne Sektor, rezulton me 91% te praktikave te trajtuara, kjo e fundit pavaresisht kufizimeve ne përbërje të struktures (mungesës së stafit) është bërë e mundur si rezultat i perkushtimi maksimal nga ana e stafit, si dhe e kualifikimit, aftesive profesionale te tyre.

II. Çertifikatat e Rezidences.

Vërtëtimi i rezidencës i lëshohet tatimpaguesve të regjistruar në organet tatimore Shqiptare nga DPT, pas kërkesës me shkrim të tatimpaguesit, dhe pasi bëhen verifikimet e nevojshme në Degën e Tatimeve ku ai është i regjistruar.

Vërtëtimi i residencës i shërben tatimpaguesit për të vërtetuar se paguan tatimet për të ardhurat globale në Shqipëri, në mënyrë që organi tatimor i shtetit të huaj, ku ai ka realizuar të ardhurat të bëjë aplikimin e Marrëveshjes *(duke aplikuar, sipas rastit, tarifën e reduktuar ose duke mos i tatuar ato të ardhura)*.

Sektori i taksave direkte per vitin 2021 ka trajtuar rreth 208 kerkesa për çertifikate residence, të adresuara për sektorin nga individe, rezidente ne RSH si dhe nga individe resident ne RSH, me nenshtetesi te huaj.

Muaji'21	Certifikate Residence
1	21
2	12
3	32
4	9
5	16
6	14
7	19
8	15
9	13
10	32
11	12
12	13
Total	208



Siç konstatohet edhe nga grafiku periudhat që kanë numër të lartë kërkesash për Certificate Residence janë muajt Janar/Mars/Tetor/Korrik.

III. Shkëmbimi i informacionit me administratat tatimore EOIR

Një nga detyrat e Sektorit të Taksave Direkte është dhe shkëmbimi i informacionit me administratat e tjera tatimore me qëllim zbatimin e marrëveshjeve tatimore për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe për parandalimin e evazionit fiskal. Gjatë kësaj periudhe janë kryer shkëmbime të iniciuara nga Sektori, në rastet e dyshimeve për deklarimin apo jo të të ardhurave të tatimpaguesve. Gjithashtu gjatë vitit 2021 kanë hyrë kërkesa për shkëmbime të informacionit, iniciuar nga shtetet e huaja dhe/ose administratat tatimore homologe, që kërkojnë informacione të ndryshme.

IV. Shkëmbimi Automatik i Llogarive Financiare

Nëpërmjet stafit SPOC (*Single Point of Contact*), pjesë e Sektorit të Taksave Direkte, janë dërguar paketat e të dhënave ndaj Juridiksioneve Pjesëmarrëse, si dhe në kuadër të vlerësimit të bërë nga ekspertët e OECD-së në Shtator 2021, Administrata Tatimore për herë të parë ka marrë informacion nga 25 Juridiksione, ku në total janë raportuar 7.218 llogari bankare.

Sektori i Taksave Direkte ka ofruar bashkëpunimin me angazhim të plotë në hartimin e kuadrit ligjor për shkëmbimin automatik të informacionit mbi llogaritë financiare në kuadër të Standartit të Raportimit të Përbashkët (CRS-Common Reporting Standard).

Gjithashtu, sektori ka asistuar dhe trajtuar kërkesat e ardhura për interpretim të këtyre akteve ligjore nga institucionet financiare raportuese, si dhe ka marrë pjesë në të gjitha takimet informuese të zhvilluara me institucionet financiare.

IV. Angazhime te inspektoreve ne grupe pune te ngritura ne zbatim te akteve ligjore dhe Urdherave te Drejtorit te Pergjithshem te Tatimeve.

Sektori i taksave direkte ka angazhuar me kohe te plote 2 inspektore, ne grupin e punes te ngritur ne kuader te rindertimit si dhe nje inspektor ne trajtimin e ankesave të ardhura nga platforma e bashkëqeverisjes si një praktikë efikase ndërveprimi me qytetarët. Gjatë vitit 2021 janë trajtuar mbi 2100 ankesa në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të administratës tatimore, duke patur si synim kryesor që të mundësohet dhënia e përgjigjeve për ankuesit brenda afateve të përcaktuara.

V. KONTROLLI TATIMOR

Gjatë vitit 2021, Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT, bazuar në objektivat Strategjike të hartuara, punoi dhe realizoi detyrat e ngarkuara në funksion të rritjes së performancës së administratës tatimore për mbledhjen dhe realizimin e të ardhurave buxhetore si dhe udhëheqjen metodologjike të Drejtorive të Kontrollit në DRT-të.

Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT ka funksion kontrollin e performancës së realizimit të detyrave nga Drejtoritë e Kontrollit në DRT dhe ofrimi i asistencës së duhur profesionale dhe analiza e dhënave statistikore të situatës së kontrolleve.

Objekti kryesor i Drejtorisë së Kontrollit në DPT është udhëheqja metodologjike e funksionimit të kontrollit tatimor dhe monitorimi i punës së drejtorive tatimore rajonale.

Realizimet e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, bazuar në Rregulloren e Brendshme të Administratës Tatimore, në kërkesat e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave në zbatim të tij, në zbatim të objektivave të Planit Strategjik, si dhe në ndjekje të rekomandimeve të FMN-së.

Detyrat funksionale të drejtorisë së kontrollit janë si më poshtë dhe janë realizuar në përputhje me objektivat e miratuar në planin operacional për vitin 2021:

- Kryen kontrole dhe bën verifikime në bazë të planit vjetor në drejtoritë rajonale për të verifikuar nëse funksionet e kontrollit nga zyra dhe kontrollit në vend në këto drejtori kryhen në përputhje me procedurat e përcaktuara në Legjislacionin fiskal dhe që janë pjesë e Manualeve të Kontrollit.
- Raporton gjetjet që kanë dalë gjatë kontrolleve në lidhje me metodologjinë e kontrollit tek tatimpaguesit, mospërmbushjet apo shkeljet ligjore, ose shërbimet e ofruara për tatimpaguesin, së bashku me rekomandimet për ndryshime të mëtejshme, duke propozuar edhe masa në rastet e shkeljeve administrative e ligjore. Dhe duke analizuar problematikat e konstatuara dhe mangësitë e inspektoreve të kontrollit ai rekomandon programet e trajnimit, për rritjen e aftësive të inspektorëve.
- Monitoron arritjet e drejtorive tatimore rajonale kundrejt planeve të dërguara për zbatim nga DPT, investigon ndryshimet nga plani i kontrollit, bën komente për çdo shmangie të dukshme në masat e marra në kontroll nga ato të planifikuara dhe merr masa për të korrigjuar këto shmangie, kur

është e nevojshme. Gjithashtu, ofron këshillim dhe udhëzim të specializuar për një kontroll eficient dhe efektiv të tatimpaguesit.

- Ndjek zbatimin e planeve të kontrolleve mujore të dërguara në DRT-të, si dhe mbi bazen e rezultateve të kontrolleve mujore të raportuara nëpërmjet evidencave mujore, brenda datës 10 të çdo muaji, ka analizuar e përpunuar vlerësimet e mbledhura mbi analizën e riskut për tatimpaguesit e kontrolluar nga të gjitha drejtoritë tatimore rajonale si dhe ka mbajtur evidencë të detajuar në lidhje me numrin dhe llojin e kontrolleve për çdo DRT, duke analizuar rezultatet dhe progresin e bërë kundrejt planit dhe kundrejt faktoreve të riskut mbi të cilët subjekti është përzgjedhur për kontroll kjo në bashkëpunim me DMR.

1. Përzgjedhja për Kontroll

Në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 80, Kontrolli Tatimor, është hartuar dhe Manuali i Kontrollit Tatimor, sipas të cilit përcaktohet dhe përzgjedhja e tatimpaguesve për kontroll dhe plani mujor i tyre.

Përzgjedhja e tatimpaguesve për kontroll hartohet nga Drejtoria e Menaxhimit të Riksit pasi ka bërë seleksionimin e tatimpaguesve të cilët rezultojnë me risk sipas modulit të Riskut. Drejtoria e Kontrollit në DPT miraton 30% të kontrolleve sipas analizës së riskut të çdo propozimi nga Drejtoria e Kontrollit në DRT.

2. Objektivat për vitin 2021

Objektiva të drejtorisë së kontrollit Tatimor janë pjesë e tre objektivave kryesore të planit strategjik 2017-2021. Bazuar në objektivat strategjike përkatësisht për drejtorinë e kontrollit objektivat dhe aktivitete konkrete të ndërmarra për vitin 2021 janë si më poshtë:

Objektivi 1: *Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare.*

Nënobjektivi 1.3: Zbatimi i metodologjive dhe praktikave njëhsuese

Aktiviteti: Garanton praninë e sistemeve të qarta dhe të rregulluara për operacionet e kontrollit tatimor të tatimpaguesve, që ato të kuptohen e të pranohen si të drejta e të arsyeshme si edhe të zbatohen dhe të ndiqen vazhdimisht nga DRT;

- ✓ Përgatitje e udhëzimeve apo rregulloreve që do ndihmojnë në procesin e propozimeve të kontrollit nga Drejtoritë e Kontrollit në DRT.

- ✓ Analizimi i propozimeve nga DRT-të në lidhje me 30% të planit për kontrollet tatimore.

Kontrolle te kryera raste 2 per vitin 2021:

Gjithsej	Me zbulim	Pa zbulime	Pa zbulime %	Total zbulime TVSH	Total zbulime TF	Total zbulime sigurime	Total zbulime te tjera	Totali
468	423	45	9.6	827278	765062	38930	63199	1694469

Objektivi 2: Implementimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor:

Nënobjektivi 2.1: Zbatimi i strategjisë së përmbushjes së menaxhimit të riskut.

Aktiviteti: Miraton planet mujore të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor me detyra të të gjithë sektorëve përbërës të saj, dhe planet e punës për secilin sektor.

- Analizimi i të dhënave dhe raporteve të kontrollit në përputhje me legjislacionin për cdo DRT objekt Kontrolli dhe nxjerrje e rekomandimeve për rritjen e efikasitetit të Drejtorive të Kontrollit si dhe në udhëheqjen metodologjike të kontrollit nga Drejtoria e Kontrollit në DPT. Nga raportimet e DRT-ve kemi evidencën mbi kontrollet:

Kontrolle e planifikuara 12 mujori 2021			Kontrolle e kryera 12 mujori 2021			Realizimi i planit te kontrolleve ne %		
Gjithsej	Te plota	v. fiskale	Gjithsej	Te plota	v. fiskale	Gjithsej	Te plota	v. fiskale
1903	1158	745	1856	1133	723	97.5	97.8	97.0

- ✓ Rishikimi i rregullores për dorëzimin e Pasqyrave Financiare, për Kontrollet në DRT etj.
- ✓ Analiza Mujore e Performancës së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DRT (Sektorit të Kontrollit në Vend).

Nënobjektivi 2.2: Përmirësimi i mëtejshëm i kontrollit tatimor dhe gjurmimi i mashtrimeve tatimore.

Aktiviteti 1: Harton dhe Miraton planet operacionale të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor me detyra të të gjithë sektorëve përbërës të saj, dhe planet e kontrollit për cdo drejtori rajonale.

- Analizon punën e sektorëve të Kontrollit sipas detyrave funksionale.
 - Gjatë vitit 2021 janë monitoruar vazhdimisht sektorët e kontrollit, në lidhje me kontrollet në proces, deklaratimet, dorëzimin e pasqyrave financiare etj.

- Në mënyrë progresive mujore mbi bazë të raportimeve me email, por edhe në formë shkresorë tërheq vëmendjen e DRT-ve për zbatimin e afateve të kontrolleve bazuar në Manualin e Kontrollit Tatimor dhe Ligjit të Procedurave Tatimore.
- Harton dhe miraton planet e punës dhe planet operationale për sektorët përbërës.
- Për vitin 2021 është hartuar plani operacional për Drejtorinë e Kontrollit dhe është detajuar sipas sektorëve në plane pune.

Aktiviteti 2: Merr masa që rekomandimet dhe kërkesat e auditit të Ministrisë së Financës, Kontrollit të Lartë të Shtetit, rekomandimeve të FMN dhe institucioneve të tjera shtetërore, të ndiqen dhe zbatohen në lidhje me kontrollin e tatimpaguesve;

- Analiza e zbatimit të shkallëve të ndryshme të TVSH, sipas rekomandimit të KLSH.
- Analiza e afateve të kontrollit për shkak të ndikimit të situatës së pandemisë, dhe vonesave në kontrolle me kërkesë të tatimpaguesve, rekomandim i KLSH.
- Analiza e efektivitetit të punës së inspektorëve sipas formimit të tyre dhe shpërndarja e kontrolleve bazuar në aftësi, sipas rekomandimeve të FMN.

Aktiviteti 3: Verifikimi i Drejtorive Rajonale mbi problematikat e kontrollit tatimor, verifikimit në terren, vlerësimit dhe analizës së riskut; Realizon kontrolle në Drejtoritë Rajonale.

- Program kontrolli në DRT, lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.
- Evidentimi i problematikave që kanë nevojë për trajtim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si dhe ndjekja e tyre.
- Analiza e programeve dhe raporteve të kontrollit sipas sektorëve të ekonomisë dhe evidentimi i trajtimit i tyre në mënyrë specifike.
- Kontrolli i Përformancës së punës së Drejtorive të Kontrollit Tatimor, DRT Shkodër, Dibër, Vlorë, Kukës dhe Korçë në DRT, përdorimi i kriterëve të duhura për vlerësim, me qëllim që të prodhojë efekte në plotësimin e detyrave të ngarkuara.

Objekti 3: Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore

Nënobjekti 3.2. Zhvillimi i kapaciteteve dhe motivimi i punonjësve

Aktiviteti: Zbaton dhe rekomandon programet e trajnimit për drejtuesit dhe inspektorët e kontrollit tatimor.

- Evidentimi i nevojave për DRT dhe DPT nëpërmjet hartimit të një pyetësori, ku të përcaktohen fushat e trajnimit, sektorët, etj.

- Ndjekja e procesit të bashkëpunimit me Administratën Tatimore Suedeze, në funksion të përcaktimit të objektivave dhe fushave që asistencës së nevojshme për Drejtorinë e Kontrollit.

Nënobjektivi 3.3. Mbajtja e proceseve optimale dhe struktura e Administratës Tatimore.

Aktiviteti: Përmirësimi i cilësisë së kontrolleve. Përditësimi I procedurave të kontrollit për të siguruar kryerjen në kohë dhe në mënyrë standarte të tyre.

- Analiza e gjetjeve dhe rezultateve të raporteve të kontrollit tatimor dhe nxjerrje e rekomandimeve për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së kontrollit. Përmirësimi i cilësisë së kontrolleve. dhe përditësimi i procedurave të kontrollit për të siguruar kryerjen në kohë dhe në mënyrë standarde të tyre;

Nr. i kontrolleve të kryera me zbulime			Zbulime				
Gjithsej	Plote	v. fiskale	TVSH	T FIT	Sig Shoq	Te tjera	Gjithsej
1504	1087	417	2085330	1796499	53136.72	388470.3	4323437

- Analiza e cilësisë së raporteve të kontrollit sipas sektorëve të ekonomisë dhe specifikimit i analizave të nevojshme për t'u bërë nga inspektori i kontrollit.

Për vitin 2021 nga kontrollet e kryera janë evidentuar dhe ndjekur problematika lidhur me trajtimin në raportin e kontrollit të problematikave sipas sektorëve.

3. Aktivitete të realizuara për vitin 2021

- Drejtoria e Kontrollit ka kryer kontrolle në Drejtoritë e Kontrollit Tatimor në DRT, ne DRT e Shkodër, Sarandë, Korçë, Kukës, Dibër, dhe Vlorë dhe në proces DRT Durrës sipas programeve të kontrollit, të miratuara për këtë qëllim, për zbatimin me korrektësi dhe profesionalizëm të legjislacionit tatimor, duke u përqendruar në drejtimin metodologjik të veprimtarisë të Drejtorive të Kontrollit pranë DRT-ve. Kontrollin dhe analizen e punës së inspektorëve të sektorit të kontrollit pranë DRT-ve, bazuar në planet operacionale vjetore të miratuara për këtë qëllim, në përputhje me procedurat ligjore dhe kërkesat e akteve nenligjore të përcaktuara në rregulloret e brendshme dhe në Manualin e Kontrollit Tatimor;
- Nga drejtoria e kontrollit çdo muaj janë pranuar nga Drejtoritë Rajonale Tatimore lista me propozime për tatimpagues për t'u kontrolluar, (30%) nëse ato kanë arsye të forta për të besuar se në propozimet e tyre janë evidentuar mundësi në zbulimin e të ardhurave shtesë.
- Nga drejtoria e kontrollit janë kryer kontrolle dhe bërë verifikime në bazë të planit vjetor në drejtoritë rajonale për të verifikuar nëse funksionet e kontrollit në këto drejtori kryhen në përputhje me procedurat e përcaktuara në Legjislacionin fiskal dhe që janë pjesë e këtij Manuali.

- Nga drejtoria e kontrollit janë dërguar shkresa dhe email Drejtoritë Rajonale Tatimore në lidhje me orientimin dhe zbatimin e analizës së riskut për subjektet e përzgjedhur për kontroll sa më efektive në mbështetje të manualin të kontrollit analizën e riskut duke u mbështetur në analizën dhe propozimet e kryera nga inspektori i kontrollit nga zyra.
- Mbajtur protokolli i shkresave, shqyrtuar dhe adresuar shkresat për vitin 2021, si dhe përcjell sipas problematikave sektorëve përkatës, në respektim të afateve ligjore të kthimit të përgjigjeve të 478 shkresa.
- Trajtimi i shkresave të deleguara duke hartuar përgjigjet përkatëse si dhe në raste të caktura edhe me email.
- Ndjekja dhe hartimi raportimeve për Planin Operacional vjetor, pyetësorët e OECD, FMN si dhe analizën e performancës së Drejtorisë.
- Shqyrtimi dhe Hartimi i praktikave për rindërtimin si pjesë e grupit të punës, 745 shkresa ta hartuara.
- Drejtoria e kontrollit ka marr pjesë në cdo programe trajnimi, të organizuar në DPT në zbatimin e legjislacionit tatimor në fuqi; si fiskalizimi dhe në projekte të përbashkëta me Suedezët, FMN apo Bankën Botërore.
- Nga drejtoria e kontrollit janë ndjekur dhe marr masa në lidhje me rekomandimet dhe kërkesat e auditit të Ministrisë së Financës, Kontrollit të Lartë të Shtetit,
- Nga drejtoria e kontrollit janë ndjekur raportimet për Kontrollit të Lartë të Shtetit, për pagat e luftës, rindërtimin dhe evidence për Drejtorinë e Kontrollit.
- Nga drejtoria e kontrollit janë evaduar dhe marrë masa në lidhje me informacionin i marrë për shmangiet tatimore dhe evazionin tatimor kontroll të mëtejshëm etj. nga Drejtorisë së Hetimit Tatimor apo institucione të tjera ligjzbatuese si Prokuroria Gjykatë etj.
- Marre pjesë në trajnime dhe raportime, të organizuara në DPT në zbatimin e legjislacionit tatimor në fuqi; si fiskalizimi dhe në projekte të përbashkëta me FMN apo Bankën Botërore etj.
- Ndjekja e raportimeve dhe takimeve në kuadër të projektit të DPT me Administraën Suedeze për Drejtorinë e Kontrollit.
- Hartimi i disa raportimeve përmbledhëse nga DRT për pagat minimale, subjektet e kontrolluara për rindërtim etj.

VI.MENAXHIMI I RISKUT

Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në organigramën e DPT-së është në varesi të Drejtorisë së Hartimit të Programeve, drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së DMR dhe është e organizuar në 2 sektorë.

- Sektori i Analizës së Riskut me 1 Përgjegjes dhe 10 Specialistë (1 pozicion vakante-përgjegjës i sektorit)
- Sektori i Hartimit të Strategjive për Trajtimin e Risqeve -me 1 Përgjegjës dhe 6 Specialistë (1 pozicion vakant- Inspektor)

Objektivi parësor i modelit të riskut që ushtron veprimtarinë DMR është identifikimi mbi bazën e kritereve të miratuara dhe zhvilluara paraprakisht i tatimpaguesve që përbëjnë risk potencial lidhur me përmbushjen, veprimtaria tregtare e të cilëve do të verifikohet dhe trajtohet nga ana e administratës tatimore në harmoni me procedurat ligjore në fuqi.

1. Objektivat e Drejtorise per vitin 2021

Objektivi Strategjik i DMR është përmirësimi i analizës dhe vlerësimit të risqeve të rëndësishme të mosrespektimit të legjislacionit tatimor që ka një ndikim në uljen e hendekut të mospërmbushjes. Ky objektiv bazohet në këto shtylla të rëndësishme:

- Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve sektoriale të përmbushjes dhe reduktimi i nivelit të riskut
- Zgjerimi i kapaciteteve për të ekzaminuar të dhënat nga burime të ndryshme gjatë analizës së riskut të përmbushjes së tatimeve;
- Përdorimi i burimeve të informacionit nga palë të treta dhe sigurimi që çdo informacion të jetë i integruar në modelin e kontrollit duke u bërë një faktor për vlerësimin e riskut
- Hartimi i analizave cilësore që fokusohet në target risqe specifike
- Monitorimi i rregullt i niveleve të përmbushjes.
- Forcimi i kapaciteteve dhe bashkëpunimi i pandërprerë me bizneset duke synuar marrjen e një baze të plotë të dhënash

Tregues kryesorë të performances janë:

- Madhësia e hendekut tatimor sipas llojeve të risqeve

- Zvogëlimi i riskut të sjelljes së tatimpaguesve, pas trajtimit – reduktimi i numrit të tatimpaguesve me risk.
- Zvogëlimi i riskut të sjelljes së tatimpaguesve, pas trajtimit – reduktimi i hendekut të permbushjes.
- Vlera dhe numri i deklaratave të korrigjuara nga tatimpaguesit, si rezultat i njoftimeve të dërguara apo takimeve të mbajtura me ta.
- Lidhja e objektivave me rekomandimet e TADAT: Objektivat e DMR janë në përputhje me vleresimin e TADAT Gusht 2016, Kapitulli III
- Vleresimi i performancës së të ardhurave tatimore, POA 2 - POA 6

2. Aktivitet e programuara dhe realizuar gjate vitit 2021 ne funksion te realizimit te objektivave.

Bazuar në vendimin nr.23 date 27.05.2021 u miratua Plani Vjetor i Permbushjes për vitin 2021, i cili u publikua ne faqen zyrtare të DPT-së

Bazuar në vendimin nr 24, date 23.06.2021 të Komitetit të Përmbushjes u miratua Plani sektorial i Rindertimit.

U analizuan të dhenat tatimore për periudhen Prill 2019- Gusht 2020 për të gjithë TP të cilët janë te pajisur me autorizimin e perjashtimit nga TVSH-ja në kuader të procesit të Rindertimit. Bazuar në rregullat e thyera u percaktuan metodat e trajtimit si më poshtë:

- o 228 letra të personalizuara
- o 125 vizita fiskale
- o 45 kontrole tatimore
- o 324 kontrole nga zyra

Bazuar në vendimin nr 23, date 27.05.2021 të Komitetit të Permbushjes u miratuan Rregullat e Riskut për monitorimin e tatimpaguesve në kuader të ndryshimit të pragut të TVSH-së dhe TF.

U hartuan:

- o 5 Kriteria lidhur me Pragun e ri të TVSH-së prej 10 mln lekë (në fuqi nga 1 Janar 2021).
- o 4 Kriteria lidhur me Pragun e ri të TF prej 14 mln lekë (në fuqi nga 1 Janar 2021).

Bazuar mbi keto kriteret risku janë evidentuar tatimpaguesit me riskun potencial

Bazuar në vendimin nr 23, date 27.05.2021 të Komitetit të Permbushjes u miratua Analiza e përgjithshme e Sektoreve me risk. Nga analiza e sektoreve me risk bazuar ne rregullat e thyera te Modulit të riskut për periudhen Korrik 2020- Qershor 2021, vihet re se sektoret me risk më të lartë janë: Tregtia me pakice, Aktivitete të shërbimit të pijeve, Tregtia me shumicë dhe Ndertimi.

Bazuar në vendimin nr 23, datë 27.05.2021 u miratua Plani Sektorial i Turizmit. Plani i Turizmit u zhvillua për periudhën Maj- Shtator 2021 për të gjitha subjektet që operojnë në fushën e turizmit dhe Bar-Restorante.

Dergimi i letres të personalizuar për tatimpaguesit pjesë e sektorit duke veçuar subjektet pa përgjegjësi tatimore TVSH dhe me pas për subjektet e tvsh-së (1 letër për subjektet pa përgjegjësi tatimore, një për subjektet me tvsh dhe një për subjektet me risk për pragun e përgjegjësi).

Dergimi i mesazheve Pop-up per gjithë subjektet ne sektorin e turizmit.

Dergimi i mesazhit sensibilizues në formën e një e-mail për të gjithë punonjësit e administratës shtetërore dhe per institucionet private me numer te larte punonjesish (banka, teknologji sigurime etj).

Bazuar ne Deklaratat e TVSH-se per periudhen Korrik 2019- 2021 jane evidentuar TP me risk me larte sipas problematikave si me poshte: Numer i larte punonjesish xhiro e ulet ne pajisje fiskale, Numer i ulet punonjesish xhiro e ulet shume çadra siperfaqe e madhe, Renie xhiro mbas monitorimit, Renie xhiro mbi 1 milion korrik 2021 vs korrik 2019, Xhiro e ulet (subjekte qe kane kryer evente),

Disa nga rezultatet e Planit të Turizmit janë:

Për të njëjtët tatimpagues që kanë qënë aktiv dhe në vitin 2019, gjatë sezonit turistik të vitit 2021 është shënuar një rritje e TVSH-së së detyrueshme për t'u paguar me 15%.

- *Eshtë kryer regjistrimi në Përgjegjësinë e TVSH-se për 175 tatimpagues.*
- *Rritje me 8% e numrit të punonjësve për tatimpagues aktiv në të dy periudhat 2021-2020.*
- *Rritje me rreth 16% e numrit të punonjësve të deklaruar për popullatën e targetuar aktive (per totalin e TP).*

Miratimi i kriterëve të riskut që kanë të bëjnë për evidentimin e tatimpaguesve mospermbushës në sektorin e punësimit dhe me një ndikim të madh në informalitetin në tregun e punës të miratuara në datë 13.10.2021, në mbledhjen e 27-të e Komitetit të Përmbushjes.

Kriteri i riskut:

1. Tatimpaguesit kanë pagë të deklaruar për kontribute për 80%-100% të punonjësve të tyre deri në nivelin e pagës minimale 30,000 lekë dhe që kanë numër punonjësish mbi 5.
 2. Punonjës që i përkasin njërës nga kategoritë “I Dypunësuar....” por që figurojnë vetëm në një listëpagesë në periudhën mars 2021.
 3. TP që kanë mbi 20% te punonjësve të tyre në kategorinë: I punësuar, i cili për gjithë muajin ka qënë me raport leje barrë lindje ose raport mjekësor pas ditës së 14 dhe mer përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore, por nuk i ka shkëputur (zgjidhur) marrëdhëniet e punës me subjektin përkatës
 4. TP që kanë mbi 4 punonjës dhe 50%-100% e tyre i përkasin njërës prej kategorive:
 5. Punonjës që i përkasin kategorisë “Person i përjashtuar nga pagimi i kontributit të sigurimit shëndetësor pasi nuk është me banim të përhershëm në Shqipëri (sipas kuptimit të rezidencës të përcaktuar në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", por që kanë ID shqiptare:
 6. Tatimpagues që nuk i pëket formës ligjore “Person fizik” apo “Ambulant” por që deklarohen punëmarrës në kategoritë “I vetëpunësuar apo person i papaguar i familjes.... dhe pagë më të ulët se niveli i pagës minimale. (shmanget TAP si dhe ne disa nga këto kategori mund të deklarojë edhe pagën për kontribute më të ulët se niveli min)
 7. Tatimpagues që i përket formës ligjore “Person fizik” por që deklarojnë më shumë se një punonjës në kategorinë “I vetëpunësuar....” (Shmanget TAP)
 8. Tatimpagues që deklarojnë punonjësit e tyre në njëren nga kategoritë:
- Dhe shuma e pagës bruto është më e lartë se niveli max i pagës dhe shuma e pagës për kontribute nga të gjitha subjektet është më e vogël se niveli max.
9. Tatimpagues që ndryshojnë deklarata e tyre (listëpagesat) me rënie 20%-100% të detyrimit fillestar:

Si rezultat në dhjetor 2021 u identifikuan 3.882 tatimpagues të cilët për 62.905 punonjës të tyre kanë pagë të deklaruar deri në nivelin min. (kriteri 1). Sektorët kryesorë që i përkasin këto TP janë si më poshtë:

Sektori sipas Riskut	Tatimpagues	%
Aktivitetet e shërbimit të ushqimit dhe pijeve	526	14%
Tregtia me shumice	439	11%
Tregtia me pakicë	316	8%

Ndertimi I ndertesave	249	6%
Prodhimi i produkteve ushqimore	208	5%
Veprimtari të specializuara të ndërtimit	198	5%
Transporti tokësor dhe transporti nëpërmjet	186	5%
Akomodimi	126	3%

Për këto TP u dërguan letra të personalizuar ku kërkohet që të deklarojnë nivelin real të pagës për punonjësit e tyre. Për 1.975 TP u dërgua një letër me përmbajtje mesazhi "STRONG" dhe për 1.907 të tjerë "SOFT".

Gjithashtu në bashkëpunim me Drejtorinë Proceseve të Biznesit po punohet për inaktivizimin/ bllokimin e mundësisë në sistem të deklarimit, sipas disa risqeve të identifikuar, nga ana e TP apo shtimi i fushave të tjera për informacion ekstra, si psh:

Për tatimpaguesit që nuk i pëkasin formës ligjore “Person fizik” apo “Ambulant” të bllokohet në sistem mundësia që të deklarojnë punëmarrës në kategoritë “I vetëpunësuar apo person i papaguar i familjes

Për punëmarrësit e kategorive “I dypunësuar,,,” të shtohet edhe një fushë tjetër ku të deklarohet edhe NIPT-i tjetër ku rezulton i dypunësuar ky punëmarrës.

Nisma Dhjetor 2021

Nisma e fundit e ndërmarrë lidhur me informalitetin në tregun e punës i përket periudhës dhjetor 2021 ku u identifikuar 10.154 tatimpagues të cilët deklarojnë për 95.214 punonjës të tyre nivelin min. të pagës. Për këto tatimpagues u hartuan dhe u nisen letra të personalizuar ku ju kërkohet që të deklarojnë pagën reale për punëmarrësit e tyre nëpërmjet postës ashtu dhe në llogarinë elektronike në sistemin C@TS për tatimpaguesit.

2.1 Përmirësimi i Modulit të Riskut(rishikuar)

Rregullat e modulit të riskut janë në proces të vazhdueshëm përmirësimi pasi ndikohen drejtperdrejte nga ndryshimet në paketat fiskale, nga sjellja e tatimpaguesve si dhe nga dinamika e mjedisit ekonomik. Ne kuadër të përmirësimit të funksionalitetit të rregullave dhe pershtatjes me ndryshimin e Pragut të TVSH-së, TF-së, pas testimeve të vazhdueshme për evidentimin e problematikave të tyre, DMR ka bërë ndryshimet e nevojshme në logjikë si dhe në përditësimin e dokumentit në word.

Ne bashkëpunim me specialist në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për të siguruar mbarëvajtjen e modelit, zhvillimet e reja dhe përditësimin janë analizuar të dhënat nga Modeli i Riskut.

U rishikuan dhe iu derguan palës mirmbajtëse rregullat e Modulit të Riskut si më poshtë:

ALLBEDT - Rritje e borxhit për të gjitha llojet e tatimeve.

PRDECB - Marzhi i fitimit nga TF më i ulët krahasuar me sektorin.

TPLTOA - Eksportuesit e paster dhe blerjet e medha (raporti blerje /shitje me i madh se ai i sektorit)

TPLTOB - Qarkullim i lartë pagesë e ulët e TVSH krahasuar me sektorin

TPLTO - Qarkullim i lartë pagesë e ulët-Kombëtare

IOCIT - Deklarim fitimi në TVSH po humbje në deklaratat e TF krahasuar me veten

TCTPR- Raporti i vl Tatueshme BL/ vl te tatueshme SH e komp A krahasuar me po te njejtin raport per sektorin eshte me I larte se 20%

VATG1 -Rënie e pagesës së TVSH-së krahasuar me vitin paraardhës

Ndërkohë që janë rishikuar dhe pjesa e rregullave të mbetura nga ana e logjikës së tyre dhe do të kryhen përmirësimet e nevojshme.

2.2 Analizimi i riskut të tatimpaguesve që bëjnë kërkesë për Rimbursim

Gjatë Vitit 2021 kanë ardhur 105 kërkesa për rimbursim të cilat janë për 736 tatimpagues të ndryshëm. Bazuar në analizat 3 mujore të bazuara në ekzekutimet e Modulit të Riskut 116 tatimpagues janë propozuar për kontroll. Më poshtë tabela e specifikuar sipas muajve të vitit 2021:

Muaji	Numri i kërkesave të ardhurave	Numri i tatimpaguesve që kërkojnë Rimbursim Tvsh-je	Numri i tatimpaguesve që propozohen për kontroll bazuar në Analizën e Riskut
JANAR	7	57	15
SHKURT	8	72	5
MARS	4	26	5
PRILL	5	52	7
MAJ	11	82	8
QERSHOR	2	9	2
KORRIK	10	66	7
GUSHT	13	51	5
SHTATOR	8	65	9
TETOR	8	59	5
NENTOR	14	106	21
DHJETOR	15	91	27
TOTALI	105	736	116

2.3 Ndryshimi i përgjegjesive tatimore bazuar në të dhënat e paisjeve fiskale dhe deklaratat mujore të TVSH-së.

Gjatë vitit 2021 nga ana e DMR në mënyrë periodike janë analizuar të dhënat e paisjeve fiskale, deklaratat mujore të TVSH-së librat e blerjes së të tretëve për të parë sjelljen e tatimpaguesve në raport me përgjegjësinë tatimore që ato përfaqësojnë dhe janë dërguar neper DRT në mënyrë periodike.

2.3.1 Evidentimi në mënyrë të vazhdueshme i TP me xhiro mbi 8 milion lekë bazuar në të dhënat e deklaratave të TVSH. DRT kanë bërë verifikimet përkatëse dhe kanë marrë masa për ndryshimin e përgjegjësisë tatimore sipas rekomandimit në BM.

2.3.2 Evidentimi në mënyrë vazhdueshme i TP me shitje mbi 8 milion lekë bazuar në të dhënat e librave të blerjes së të tretëve. DRT kanë bërë verifikimet përkatëse dhe kanë marrë masa për ndryshimin e përgjegjësisë tatimore.

2.3.3 Analiza e Xhiros në kasë Janar- Dhjetor 2021. TP derguar DRT-ve për ndryshimin e përgjegjësi.

3. Analiza periodike per tatime te vecanta dhe per sektore te caktuar

Jane marre dhe iniciativa te tjera qe nxisin permbushjen vullnetare, nder te cilat permendim:

3.1 Evidentimi i TP me aktivitet të fushes së "Tregtisë", të cilët kanë Renie Qarkullimi për periudhat krahasuese Janar-Mars 2021/Janar-Mars 2019. Për këta TP u kryen verifikime në terren nga DVKT.

3.2 Evidentimi i TP aktivë me xhiro mbi 8 milion lekë sipas DRT-ve, bazuar në të dhënat e deklaratave të Tatimit të Thjeshtuar. DRT pasi kanë kryer verifikimet përkatëse kanë marre masa për ndryshimin e përgjegjësi tatimore sipas rekomandimit në BM.

3.3 Bazuar në të dhënat e deklaratave të TVSH-se për periudhën Janar- Nëntor 2021 janë analizuar të dhënat e tatimpaguesve të cilët rezultojnë me *Blerje 25% me te larte se Shitje* (pasi janë hequr Blerjet dhe Importet për Investime). Këta TP janë ndjekur nga DRT përkatëse.

3.4 Bazuar në të dhënat e deklaratave të TVSH-së për muajin Prill 2021 janë identifikuar tatimpaguesit *Mos-deklarues/Deklarues me vlere Zero* të cilët rezultojnë me Xhiro në Kasen fiskale. Këta TP janë trajtuar nga DRT përkatëse.

3.5 Bazuar në të dhënat listëpagesës Janar – Mars janë identifikuar TP *Mos-deklarues* të cilët rezultojnë me Xhiro në Kasen fiskale

3.6 Bazuar në të dhënat e deklaratave të TF janë identifikuar tatimpaguesit *Mos-deklarues. Derguar DRT-ve*

3.7 Bazuar në Deklaratat e TF, TFTH janë evidentuar TP Aktiv për të cilët *Xhiro në kase pa TVSH 2020 është me e madhe sesa të ardhurat tatimore* tek deklarata e TF , TFTH 2020,(Diferenca >100,000). Këta TP janë trajtuar nga DRT përkatëse.

3.8 Evidentimi i TP që deklarojnë ambjent me qera por nuk plotësojnë deklaratën e Tatimit në Burim derguar DRT-ve

3.9 Evidentimi i TP për të cilët Raporti i Shumes së energjise me shpenzimet ose Raporti i Shumes së energjise me të ardhurat është mbi 50%. Derguar DRT-ve

3.10 Bazuar në deklaratat e TVSH-së Janar- Tetor 2021 janë evidentuar TP që kanë plotësuar fushën Shitje me shkallë tatimore 0% për të verifikuar nga ana e DRT-ve .

3.11 Evidentimi i TP të cilat kanë diferenca Qarkullim nga deklaratat e TVSH-se – Xhiro me kasë mbi 500.000 leke. Derguar DRT-ve

3.12 Evidentimi i TP me humbje në TF por ben Kerkese per Rimbursim. Derguar DRT-ve

3.13 Dërguar DRT-ve për rregullimin e përshkrimit të aktivitetit për REV 2 për autoshkollat.

4. Fiskalizimi

Gjate periudhes 4 mujori i 3-te te vitit 2021 DMR eshte angazhuar ne monitorimin e ecurise se regjistrimit ne procesin e fiskalizimit duke derguar ne menyre periodike lista me tatimpaguesit mospermbushes tek Drejtorite Rajonale Tatimore.

5. Te tjera aktivitete te realizuara nga DMR gjate vitit 2021

Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në DPT është përgjegjëse për menaxhimin e përzgjedhjes automatike të tatimpaguesve për kontroll, bazuar në kriteret e miratuara të riskut. Hartimi i planeve mujore te kontrollit, planifikim i rasteve per rimbursim referuar shkresave te DRTVSH dhe hedhja e evidencave te kontrollit ne nje plan-fakt te perbashket per 14 DRT. Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut përzgjedh 70% të tatimpaguesve për kontroll tatimor të plotë në vend sipas të dhënave të regjistrimit elektronik të riskut, dhe do të miratojë 100% të kontrolleve që do të zhvillohen në shkallë vendi.

Jane kryer ekzekutimet e modulit të riskut për projektet sektoriale, për rimbursimin e TVSH-së apo nevoja të tjera analizash.

Gjate vitit 2021 jane kryer:

- 4 ekzekutime te Modulit te Riskut per Rimbursimin e TVSH-se
- 2 ekzekutime te Modulit te Riskut per Planet e Kontrollit

VII. MBLEDHJA ME FORCË

Në zbatim të detyrave operacionale, menaxhimi i detyrimeve të papaguara në afat gjatë vitit 2021 është mbështetur në objektivat strategjike dhe është përqëndruar në garantimin e mbledhjes së detyrimeve të prapambetura, duke siguruar respektimin e të drejtave të tatimpaguesve, uljen e ekspozimit ndaj rreziqeve që lidhen me mbledhjen e detyrimeve të prapambetura dhe në të njëjtën kohë, evidentimit sa më real të gjendjes së detyrimeve tatimore, bazuar në të dhënat e dërguara nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, sipas evidencave që raportohen çdo muaj nga ana e tyre.

Ecuria dhe gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në afat deri në 31 Dhjetor 2021 paraqitet si më poshtë:

Gjendja e detyrimeve të papaguara në afat në datë 01.01.2021	122.5 mld lekë
--	----------------

Gjendja në datë 31 Dhjetor 2021	134.9 mld lekë
---------------------------------	----------------

Në detyrimet prej 134.9 mld lekë, të cilat ndiqen deri më 31 Dhjetor 2021, është e përfshirë edhe vlera prej 14.3 mld lekë, e cila është në proces gjyqësor, ku deri në fund të Dhjetor 2021 zë 10.6% të stokut të detyrimeve të papaguara.

Gjatë periudhës së marrë në analizë, detyrimet tatimore kanë pësuar një rritje neto 12.5 mld lekë në krahasim me fillimin e vitit ose thënë ndryshe është rritur stoku i detyrimeve me 10.2%, ku theksojmë se 7 tatimpagues kapin vlerën e 9 mld nder të cilet vetëm dy tatimpagues si rezultat i vlerësimeve tatimore me metoda alternative kanë shtuar detyrimet me rreth 7.4 mld lekë.


Detyrimet e pakesuara gjatë vitit 2021 janë 21 mld lekë. Në detyrimet e pakesuara përfshihen arketimet dhe sistemimet e ndodhura gjatë periudhës.

Detyrimet tatimore të papaguara në afat deri më 31 Dhjetor 2021 të specifikuara sipas zërave përbërës paraqitet si më poshtë:

- Detyrimi 60 %
- Penalitete 35%
- Kamatevonesa 5%


Nga të dhënat e mësipërme rezulton se principi i detyrimeve tatimore të akumuluar përbën rreth 60% të shumës totale të detyrimeve tatimore, ndërkohë që pjesa tjetër e këtyre detyrimeve 40% e mbetur përbëhet nga penalitetet dhe kamatëvonesat.

Grafiku 1. Detyrimet sipas Llojit të Tatimit



Në stokun e detyrimeve të papaguara në afat të ndarë sipas llojit të tatimit, TVSH zë peshën më të madhe në stokun me borxhit me 35% në vlerë 47,7 mld lekë, e ndjekur nga Tatim Fitimi me 29% në vlerë 38,8 mld lekë, zëri Të Tjera me 17% në vlerë 23,5 mld lekë, Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore me 13% në vlerë 17.7 mld lekë, Tatimi në Burim me 3% në vlerë 4.7 mld lekë, TAP me 2% në vlerë 2,2 mld lekë dhe DIVA me 0.2% në vlerë 298 mln lekë.

Grafiku 2. Detyrimet sipas Llojit të Tatimit 2020 vs 2021



Krahasuar me fundin e vitit 2020, gjatë këtij TVSH është rritur me 5.8 mld lekë, Tatim Fitimi me 5.4 mld lekë, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore me 0.7 mld lekë, zëri Të Tjera me 0.4 mld lekë dhe TAP me 0.1 mld.

Mosha e detyrimeve të papaguara në afat

MOSHA E BORXHIT DERI NË 31.12.2021

Periudha	borxhi deri në 3 muaj	borxhi nga 3 - 6 muaj	borxhi nga 6-12 muaj	borxhi nga 1-2 vjet	borxhi nga 2-5 vjet	borxhi mbi 5 vjet
Detyrimet e papaguara ne afat	3,552,603	4,265,582	11,902,699	10,505,337	52,380,756	52,327,704


Në total stokun e borxhit mld lekë, borxhi sipas vjetërsisë paraqitet si më sipër ku:

- *borxhi deri në 3 muaj* **3% ndaj totalit të stokut**
- *borxhi nga 3 - 6 muaj* **3% ndaj totalit të stokut**
- *borxhi nga 6-12 muaj* **9% ndaj totalit të stokut**
- *borxhi nga 1-2 vjet* **8% ndaj totalit të stokut**

Borxhi me vjetërsi mbi 2 vjet **në vlerë 104,7 mld lekë është 78% ndaj totalit të stokut**

Referuar moshës së detyrimeve te papaguara vihet re se detyrimi me i ri është arkëtuar duke përdorur analizën e profilit të riskut (detyrimet me i ri dhe vlera më e lartë) si dhe duke ndjekur vetëdeklarimet për çdo muaj nga “Sektori i Monitorimit dhe Analizës” në Rajonet e Mbledhjes, me qëllim rritjen e performacës në arkëtimin e detyrimeve tatimore.

Grafiku 3. Detyrimet sipas statusit te tatimpaguesit



- *Tatimpaguesit Aktivë zënë 42.5 % të numrit total të tatimpaguesve debitorë me një vlerë prej 46,8 mld lekë ose 35 % të masës totale të borxhit.*
- *Tatimpaguesit Pasivë zënë 57.5% të numrit total të tatimpaguesve debitorë me një vlerë prej 88,1 mld lekë ose 65% të masës totale të borxhit.*

Gjatë vitit 2021 janë ndërmarrë një varg iniciativash për të forcuar funksionin e mbledhjes së detyrimeve të prapambetura tatimore me fokus forcimin e kuadrit ligjor, përmirësimin e proceseve të punës, lehtësimin e proceseve të komunikimit me tatimpaguesit me qëllim ndjekjen e menjëhershme të detyrimit të ri, duke parandaluar kthimin e tij në detyrim të vjetër për mos përshkallëzimin e stokut të detyrimeve aktual.

Nga ana e Rajoneve të Mbledhjes ka vijuar zbatimi i procedurës së komunikimit me tatimpaguesit duke patur për qëllim vetëpërmbylljen vullnetare të detyrimeve të papaguara si dhe sqarimin e procedurave të mbledhjes me forcë të cilat do të vijojnë në zbatim të ligjit.

Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara në DPT ka monitoruar ecurinë e stokut të detyrimeve, ka kryer analiza të situatës së detyrimeve në nivel tatimpaguesi dhe veçanërisht atyre më të mëdha, masave të ndërmarra në lidhje me to në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

VIII. RIMBURSIMI I TVSH-SË

Objekti dhe detyrat e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së

Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së është struktura që merret me trajtimin, miratimin dhe kryerjen e procedurës së rimbursimit të TVSH-së në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale Tatimore, Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut në DPT dhe Drejtorinë TIK të Tatimeve.

Detyrat e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së, janë si më poshtë vijon:

1. Të lehtësojë zbatimin me përpikmëri të legjislacionit tatimor në fushën e rimbursimit të tvsh-së si dhe unifikimin e procedurës së ndjekur lidhur me trajtimin e praktikave;
2. Të kryejë procedurën e rimbursimit të tvsh-së bazuar në analizën e riskut;
3. Të kryejë përveç procedurës së rimbursimit të TVSH-së bazuar në analizën e riskut edhe procedurën e rimbursimit të TVSH-së nëpërmjet sistemit të thesarit, nëse kërkesa për rimbursim tvsh-je është bërë:
 - nga organizatat jofitimprurëse për tvsh-në e paguar në blerje, për mallra të destinuara për eksport për përmbushjen e qëllimit si pjesë e veprimtarisë së tyre bamirëse jashtë Shqipërisë në kuadër të marrëveshjeve të posaçme;
 - nga çdo udhëtar jo i vendosur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë për blerje mallrash të destinuara për tu transportuar në bagazhin personal të udhëtarëve;
 - në kuadër të marrëveshjeve financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose në kuadër të marrëveshjeve të granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, në të cilat parashikohet mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, në bazë të parimit të reciprocitetit për TVSH-në e paguar për blerjet brenda vendit nga misionet diplomatike, organizatat ndërkombëtare dhe personeli i tyre.

Baza Ligjore

Baza ligjore për rimbursimin e TVSH-së është e përcaktuar në:

1. Nenin 77 të Ligjit 92/2014 datë 27.4.2017 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH” i ndryshuar,
2. Nenin 62, 63 dhe 64 të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH”, i ndryshuar,

3. Nenin 75/1 të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Per Procedurat Tatimore ne RSH” i ndryshuar,
4. Pikën 75/1 të Udhëzimit Nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar,
5. VKM nr. 953, datë 29.12.2014, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" për qëllime të rimbursimit të TVSH-së, e ndryshuar,
6. Udhëzimin Nr. 19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të vecantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar” i ndryshuar,
7. “Rregulloren e Rimbursimit të TVSH-së mbështetur në analizën e riskut” dhe
8. “Manualin për rimbursimin e TVSH-së”.

Çdo person i tatueshëm, i cili plotëson kushtet e parashikuara në nenin 77 të ligjit 92/2014 "Për TVSH-në", ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e TVSH-së.

1. Një person i tatueshëm kërkon rimbursim të tepricës së kreditimit tatimor të TVSH-se nëse:

- a) personi i tatueshëm ka mbartur tepricën e TVSH-së së zbritshme për 3 muaj radhazi, sipas pikave 2 dhe 3, të nenit 76, të këtij ligji;
- b) TVSH-ja e kërkuar për t’u rimbursuar tejkalon shumë prej 400 000 lekësh.

Procedura e rimbursimit është e percaktuar në nenin 75/1 të Ligjit nr. Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Per Procedurat Tatimore ne RSH” i ndryshuar dhe pikes 75/1 te Udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar.

Gjithashtu, brenda afatit ligjor 30 ditor, bazuar në nenet 63 dhe 64 të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH”, i ndryshuar, kryhet :

- Rimbursimi i TVSH-së për projektet e kryera në kuadër të marrëveshjeve financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose në kuadër të marrëveshjeve të granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave. **Neni 63**
- Rimbursimi i TVSH-së së paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve për projektet e kryera në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA I) dhe Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II). **Neni 63**
- Rimbursimi i TVSH-së së paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve, për misionet diplomatike dhe organizatat ndërkombëtare. **Neni 64**

Aktivitetet e programuara dhe realizuara për vitin 2021

Bazuar në planin e aktiviteteve për vitin 2020, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së ka realizuar aktivitetet kryesore të mëposhtme:

- I. Trajtimi dhe Rimbursimi i kërkesave për rimbursim të TVSH-se sipas afateve ligjore;
- II. Rishikimi i Rregullores së Rimbursimit të TVSH-së;
- III. Ndryshime Neni 10 "Përcaktimi i kategorisë së eksportuesve për qëllim të rimbursimit të TVSH-së";
- IV. Publikimi i Stokut të Rimbursimit të TVSH-së;
- V. Automatizimi i sistemit të trajtimit të kërkesave për rimbursim.

Trajtimi dhe Rimbursimi i kërkesave për rimbursim të TVSH-se sipas afateve ligjore;

Ecuria e treguesve të rimbursimit për vitin **2021** është si më poshtë:

Kerkesat: Gjate periudhes Janar - Dhjetor 2021, pranë DRTVSH-se janë regjistruar **1,643 kërkesa** për rimbursim (nga 1,476 kërkesa të regjistruara në 2020), me vlerë totale **21,726 milion leke** (nga 21,620 milion leke në 2020). Gjithsej **jane pranuar 1,220 kërkesa** (nga 1,066 kërkesa të pranuar në 2020), me një rritje në numër rreth 14.4% krahasuar me 2020, me vlerë **16,496 milion leke** (nga 15,550 milion leke në 2020), me një rritje në vlerë rreth 6.1% krahasuar me 2020, dhe **423 kërkesa** me vlerë **5,230 milion leke** (nga 410 kërkesa në 2020, me vlerë 6,070 milion leke), **nuk jane pranuar** për mosplotësim të kriterëve ligjorë.

- Nga 1,220 kërkesa të pranuar, **61 kërkesa** me vlerë **595 milion leke** janë bërë nga tatimpagues të klasifikuar si eksportues me Risk Zero, kërkesa e të cilëve duhet të miratohen dhe rimbursohen automatikisht brenda 30 ditëve nga data e kërkesës;
- Nga 1,220 kërkesa të pranuar, **682 kërkesa** me vlerë **7,769 milion leke** janë bërë nga tatimpagues të klasifikuar si eksportues, kërkesa e të cilëve duhet të miratohet dhe rimbursohet brenda 30 ditëve nga data e kërkesës;
- Nga 1,220 kërkesa të pranuar, **477 kërkesa** me vlerë **8,132 milion leke** janë bërë nga tatimpagues të klasifikuar si jo-eksportues, kërkesa e të cilëve duhet të miratohet dhe rimbursohet brenda 60 ditëve nga data e kërkesës.

Rimbursimet: Gjate periudhes Janar - Dhjetor 2021, jane rimbursuar ne total (FIFO + Keste) **24,101 milion leke**, rreth **46 % me shume se ne 2020** (nga 15,608 milion leke ne rimbursuar ne 2020) dhe rreth **42 % me shume se plani 2021** (17,000 milion leke).

Jane miratuar dhe rimbursuar **1,244 kerkesa** te trajtuara sipas metodës FIFO (nga 1,008 kerkesa te pranuar ne 2020), me nje rritje ne numer rreth 23 % krahasuar me 2020, me vlere totale per rimbursim **13,347 milion leke** (nga 8,942 milion leke ne 2020) me nje rritje ne vlere rreth 43 % krahasuar me 2020. Te gjitha kerketat FIFO te miratuara per periudhen Janar - Dhjetor 2021 jane rimbursuar ne kohe, duke bere qe mos te kemi stok te kerketave nen 150 milion leke ne fund te vitit 2021.

Pagesa e tatimpaguesve jo FIFO ka vijuar duke rimbursuar me keste ne total **10,753 milion leke** per periudhen Janar - Dhjetor 2021 (nga 7,566 milion leke ne 2020) me nje rritje ne vlere rreth 42 % krahasuar me Janar - Dhjetor 2020.

Pjesa me e madhe vleres se rimbursuar (rreth 69 %) eshte dhene per tatimpaguesit e DTM (ndikuar nga tatimpaguesit e trajtuar jo FIFO).

Nr.	Rimbursuar sipas DRT-ve (000 leke)		
	DRT Tatimore	Numri i Kerketave	Vlera e Rimbursuar
1	BERAT	49	240,957
2	DIBER	14	133,849
3	DURRES	265	1,377,357
4	ELBASAN	52	538,148
5	FIER	131	1,018,338
6	GJIROKASTER	32	99,114
7	KORCE	64	208,204
8	KUKES	3	29,500
9	LEZHE	19	147,234
10	SARANDE	40	216,201
11	SHKODER	52	183,790
12	TIRANE	242	2,816,584
13	DTM	273	16,651,143
14	VLORE	78	440,185
TOTALI		1,314	24,100,604

Koha e Rimbursimit: Ne lidhje me kohen e procesimit (koha mesatare e miratimit te kerkeses per rimbursim te TVSH-se, nga data e kerkeses deri ne daten miratimit te kerkeses), per periudhen Janar - Dhjetor 2021, jane miratuar dhe rimbursuar **1,244 kerkesa FIFO**, koha mesatare e procesimit ka

qene **67 dite**, nga **70 dite** qe ishte per 2020, ku **35 %** te kerkesave jane procesuar brenda **30 diteve**. Rreth **61 %** e kerkesave jane procesuar brenda afatit **60-ditore**.

Duhet theksuar se **13 %** e kerkesave jane procesuar mbi **120 dite** dhe kryesisht arsyeja ka qene mospagimi i detyrimeve per “**1900, Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore**”, nga ana e tatimpaguesve. Po te perjashtojme kerkesat e procesuara ne mbi **120 dite**, te cilat jane kryesisht per faje te tatimpaguesit, koha mesatare e procesimit do te ishte **51 dite** nga **70 dite**.

Dite	<31	31-60	61-90	91-120	>120	Total
Numer	435	327	220	99	163	1,244
%	35	26	18	8	13	100

Duhet theksuar se gjate 12-mujorit 2020, rimbursimi i TVSH-se, (koha mesatare e Rimbursimit te kerkeses per rimbursimte TVSH-se, nga data e kerkeses deri ne daten e kalimit ne thesar), eshte bere mesatarisht ne rreth **75 dite** nga **83 dite** qe ishte ne vitin 2020.

Stoku me 31.12.2021: Stoku i rimbursimeve per kerkesat e miratuara dhe te pa likujduara nga administrate tatimore, ne date 31.12.2021, ishte **476,650,390 leke**, duke shënuar një rënie me **95 %** krahasuar me stokun në fund të tremujorit të katërt 2020. Stoku analitik eshte si me poshte:

DRT	NIPT	Subjekti	Lloji i aktivitetit	Stoku 31.12.2021	Komente
DTM	K02727230T	KURUM Sha	Prodhim dhe tregtim i hekurit	476,650,390	Pezulluar, eshte referuar ne prokurori nga Drejtoria e Hetimit Tatimor per skema mashtrimi me TVSH-ne.
TOTAL				476,650,390	

Administrata Tatimore i qëndroi objektivit që kishte në fillim të vitit 2021 duke çuar drejt zeros stokun e rimbursimit të TVSH-së në mbyllje të vitit 2021. Gjithashtu, kërkesat FIFO u rimbursuan të gjitha në afat duke mos krijuar stok në fund të këtij tremujori.

Kerkesat ne proces: Deri ne date 31.12.2021 ne Drejtorine e Rimbursimit rezultojne se jane ne proces ne total rreth **202 kekresa** (nga 245 kekresa qe rezultonin ne 31.12.2020), me nje renie ne numer rreth 17.6 % krahasuar me 2020, ne vlere **3,841 milion leke** (nga 4,679 milion leke ne 31.12.2020) me nje renie ne vlere rreth 17.9 % krahasuar me 2020:

Kerkesat ne proces te regjistruara sipas viteve		
Viti	Numri i kerkesave	Vlera e Kerkesave
2017	1	
2019	3	
2020	9	
2021	189	
Total	202	

Marreveshjet me Keste: DPT, ne mbeshtetje te ligjit Nr.9920, date 19.05.2008, "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, si dhe te VKM Nr. 146, date 13.02.2020 "per procedurat dhe kriteret e marreveshjes per pagesen me keste te Tatimit mbi Vleren e Shtuar, te miratuar per rimbursim", ka miratuar Urdherin, Nr 20, date 02.03.2020, per miratimin e formatit te projekt-marreveshjes "Per Pagesen me Keste te Tatimit mbi Vleren e Shtuar, te Miratuar per Rimbursim".

Per vitin 2021 eshte arritur marreveshje me tatimpaguesit:

- **ALBANIAN HIGHWAY CONCESSION Shpk;**
- **CWI-ALBANIA (ÇOKYASAR WIRE INDUSTRY ALBANIA) Sha me NIPT L93411205H;**
- **ALBCHROME Shpk me NIPT K11613001M;**
- **EUROPETROL DURRES ALBANIA Sha me NIPT K24010212N.**

[Rishikimi i Rregullores së Rimbursimit të TVSH-së](#)

DRTVSH, ne mbeshtetje te qellimit te Administrates Tatimore per automatizimin e procesit te rimbursimit, rimbursimit ne kohe te kerkesave te regjistruara prane DRTVSH-se dhe uljen e numrit te kerkesave te cilat dergohen per kontroll para rimbursimit, propozoi ndryshime/lehtesime ne kriteret qe analizohen gjate procedures se rimbursimit nga DRTVSH.

Ndryshimet e propozuara the te miratuara me rregulloren e rishikuar (hyre ne fuqi me date 09.11.2021), thjeshtojne me tej procesin e rimbursimit dhe lehtesojne filtrat e riskut per disa kategori ne menyre qe nje numer me i madh i kerkesave te marin rimbursimin pa kontroll (rreth 70 te totalit te kerkesave), duke ulur ngarkesen e administrates dhe duke rimbursuar ne kohe te gjitha kerkesat sipas afateve ligjore:

Ndryshime Neni 10 "Përcaktimi i kategorisë së eksportuesve për qëllim të rimbursimit të TVSH-së";

Ne Zbatim te Planit Operacional 2021 DRTVSH paraqiti propozimet per ndryshimet te Nenit 10 "Përcaktimi i kategorisë së eksportuesve për qëllim të rimbursimit të TVSH-së", në VKM Nr. 953 datë 29.12.2014 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014 Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar" i ndryshuar, për të thjeshtuar dhe saktësuar kategoritë e eksportuesve si edhe afatet respektive të rimbursimit, mbështetur edhe në rekomandimet e KLSH-se.

Domosdoshmëria për saktësimin e nenit 10 të VKM të sipërcituar, erdhi si nevojë e:

- Zbatimit të rekomandimeve të FMN për të lehtësuar kategorinë e eksportuesve për të dhënë rimbursimin e TVSH-së automatikisht pa procedure kontrolli per kategorite pa risk;
- Zbatimit e rekomandimeve/gjetjeve të auditit të KLSH-së për vitin 2018 dhe 2019 ku shprehin paqartësi në kategorizimin e kërkesave të bëra nga personat eksportues të klasifikuar me Risk Zero;
- Implementimit të platformës dixhitale të rimbursimit të TVSH-së, e cila e do automatizojë të gjithë procesin duke shmangur shkëmbimin apo/dhe dorësimin shkresor të dokumentacionit siç parashikohet në nenin 10 të VKM-së aktuale, pika 1, gëra C;
- Legjitimitit të përfshirjes së elementëve të hetimit tatimor, me propozim nga MFE, në analizën e riskut të përcaktuar në rregulloren e rimbursimit.

Publikimi i Stokut të Rimbursimit të TVSH-së;

Ne zbatim te urdherit Nr. 28, date 08.04.2020, nr. 6380 Prot, ne mbeshtetje te Ligjit nr. 9920, date 19.05.2008, "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar dhe Ligjit nr. 92/2014, "Per Tatimin mbi Vleren e Shtuar ne Republiken e Shqiperise", Drejtoria e Rimbursimit te TVSH-se cdo tre muaj pergatit dhe publikon nje raport te detajuar statistikor lidhur me ecurine e procesit te rimbursimit per tremujorin per treguesit:

- Numrin e pergjithshem te kerkesave te trajtuara;
- Numrin e kerkesave te refuzuara;
- Vlera e rimbursimeve te ndara sipas tatimpaguesve me keste dhe FIFO;
- Stoku i rimbursimeve i detajuar sipas tatimpaguesve me keste dhe te tjere.

Publikimi i ka vijuar sipas planit, ne website e DPT.

Automatizimi i sistemit te trajtimit te kerkesave per rimbursim.

Platforma dixhitale e rimbursimit e cila pritet te vihet ne funksion ne fillim te vitit 2022, do të ul kohen e trajtimit të kerkesave duke garantuar trajtimin sipas radhës dhe do të mundesoje gjurmimin e kërkesës në çdo kohë dhe llogaritjen e kamatvonesave (interesit) per kerkesat e miratuara dhe te pa rimbursuara ne kohe. Gjate vitit 2021 jane mbajtur komunikime me kompanine zhvilluese lidhur me implementimin e platforms ku eshte specifikuar workflow qe duhet te ndiqet si dhe jane dhene pergjigje te gjitha pyetjeve te ngritura nga perfaqesuesit te kompanise zhvilluese te platformes. Gjate muajit Tetor 2021 DRTVSH ka marre ne doresim versionin test te platformes ku jane bere testime ne kete ambient.

IX. DREJTORIA E VERIFIKIMIT DHE KOORDINIMIT NË TERREN

1. Organizimi

Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren (DVKT), është e organizuar dhe ushtron veprimtarinë funksionale në zbatim të Urdhër Nr.33, datë 12.02.2020 i Kryeministrit të Shqipërisë “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore”.

2. Qëllimi

Parandalimi, ndërgjegjësimi, evidentimi dhe goditja e paligjshmërisë në fushën e tatim-taksave për tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë.

Goditja e evazionit fiskal, dhe marrjen e masave administrative përkatëse.


3. Objektivat:

- Garantimi i përmbushjes vullnetare në realizimin e objektivave të Administratës Tatimore për mbledhjen e të ardhurave dhe zbatimin me korrektësi të kërkesave të legjislacionit tatimor;
- Monitorimi i qarkullimit të xhiros ditore, inventarizimi material në tatimpaguesit me xhiro të qarkullimit mbi 14 milionë lekë sipas kriterëve të Riskut;
- Verifikimi dhe monitorimi i tatimpaguesve me veprimtari në fushën e turizmit, në aktivitete të transportit dhe në tregjet e shumicës për lëvizjen e mallrave me dokumentacion tatimor;
- Realizimi i detyrave funksionale për kontrollet në terren si dhe ezaurimi i shkresave/ listave të subjekteve;
- Mbledhja, analizimi, shpërndarja dhe trajtimi i ankesave të ardhura pranë Sektorit të Trajtimit të Ankesave;
- Verifikime në terren në zbatim dhe në përmbushje të procesit të fiskalizimit;
- Bashkëpunime me struktura të tjera ligjzbatuese.


4. Realizimet

Rezultatet totale të kontrolleve dhe shkeljeve të kryera për periudhën Janar – Dhjetor 2021:

Grafiku 1: Verifikimet dhe Shkeljet e DVKT-së



Grafiku 1: Verifikimet dhe Shkeljet e DVKT-së




Grafiku 2: Vlera e Shkeljeve sipas rajoneve të DVKT-së

Shkeljet kryesore për periudhën Janar- Dhjetor 2021 renditen, të evidentuara sipas llojit si më poshtë:

- 80 tatimpagues të penalizuar për shkeljen e moslëshimit të kuponit tatimor (rasti i parë);
- 108 tatimpagues janë penalizuar pasi janë konstatuar me punonjës të padeklaruar, nga të cilët 40 subjekte janë të përgjegjësishë tatimore “biznes i madh” dhe 68 subjekte janë të përgjegjësishë tatimore “biznes i vogël”;
- 29 tatimpagues janë konstatuar se nuk kanë pasur të instaluar pajisjet fiskale;

- 29 të tjerë nuk i mbanin pajisjet fiskale në gjendje pune;
- 40 tatimpagues janë konstatuar se dispononin mallra pa dokumentacion tatimor;
- 47 subjekte të paregjistruara në organin tatimor;
- 171 shkelje të tjera të legjislacionit tatimor të konstatuara.



Grafiku 3: Shkeljet kryesore të DVKT-së në përqindje

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut gjithashtu janë gjeneruar lista për subjektet e pafiskalizuar për të cilët janë ngritur grupe pune në lidhje me sensibilizimin e tatimpaguesve mbi procesin e fiskalizimit dhe këshillimin e tyre për të përmbushur detyrimet tatimore, punë e cila është në vazhdimësi.

Gjatë vitit 2021 rezultojnë 490 shkresa hyrëse të cilat janë trajtuar nga Drejtoria e Verifikimit në Terren sipas lëndës së përcaktuar..

5. Denoncime/Ankesa

Sektori i Trajtimit të Ankesave për periudhën Janar – Dhjetor 2021, ka regjistruar në total 1826 raste, më konkretisht:

Nr	Forma e marrjes së denoncimit	Nr i denoncimeve të	Të ezauruara	Të paezauruara
1	Raste Abuzive (Janar – Dhjetor)	681	657	24
2	Stop Informalitetit (Korrik – Dhjetor)	1126	1089	37
3	Bashkëqeverisja (Nëntor – Dhjetor)	19	18	1
	TOTALI	1826	1764	62

Nga rastet e ardhura në mënyrë analitike denoncimet janë të ndara si më poshtë:

Nr.	Forma e marrjes së denoncimit	Nr i denoncimeve të	Të ezauruara	Të paezauruara
1	Me what's Up	88	85	3
2	Me Telefon	187	182	5
3	Me Email	254	243	11
4	Me Shkresë	53	46	7
5	Me Takim	85	83	2
6	Me Email kom.digital	2	2	0
7	Me Email Koodinatori Ram Papa	6	5	1
8	Me Email Zyra e shtypit DPT	3	3	0
9	Me Email Komisioni Mbrojtjes	1	1	0
10	Me Viber	2	2	0

Në lidhje me ndarjet (format e marrjes së denoncimeve) të sipërcituara në rastet e ezauruara janë marrë dhe penalitete të ndara sipas llojit të tyre, më konkretisht:

Nr.	Lloji i penaltetit	Nr i penalteteve të vendosura
1	Bllokim aktiviteti	17
2	Mosdeklarim punonjësi	18
3	Administrim blloku, flete jo tatimore	10
4	Mosmbajtje dokumentacioni	1
5	Moslëshim kuponi tatimor	13
6	Mospërditësim adrese/të dhënash	4
7	Mospajisje me kasë fiskale	4
8	Prishje shiritash, konfiskim	1
9	Mall pa faturë	3
10	Mosmirëmbajtje kase fiskale	5
11	Çmim ndryshe nga ai i afishuari	1

Nga muaji Janar deri në fund të muajit Prill, STA është marrë me orientimin e shumë individëve për pagën e luftës për periudhën e Pandemisë si dhe dhënien e asistencës për DIVA-N (Deklarata Individuale Vjetore e të Ardhurave).

Gjithashtu dhe me problemakinën e fiskalizimit, më konkretisht nga 1 Janari i 2021 ka hyrë në fuqi fiskalizimi për mardhënien e Biznesit me Shtetin, ku nga ana jonë janë bërë orientimet përkatëse drejt numrit të telefonit të Qendrës së Thirrjeve dhe Shërbimit të Tatimpaguesëve.

Spektori i Trajtimit të Ankesave që prej muajit Qershor ka marrë në ndjekje 1126 Ankesa nga të cilat janë ezaurua 1076 raste.

Rastet e administruara si më poshtë:

Nr.	DVKT	Nr i denoncimeve të ardhura	Të ezauruara	Të paezauruara
1	Task Forca	148	148	0
2	Rajoni Qendror	578	551	28
3	Rajoni Jugor	171	168	3
4	Rajoni Verior	224	209	15

Nga totali i Ankesave të ezauruara, janë marrë në total **77 masa administrative**, më konkretisht:

Nr.	Lloji i penalitetit	Nr i penaliteteve të vendosura
1	Bllokim aktiviteti	10
2	Mosdeklarim punonjësi	22
3	Administrim blloku, flete jo tatimore	11
4	Kalim me tvsh	4
5	Moslëshim kuponi tatimor	13
6	Mospërditësim adrese/të dhënash	5
7	Mospajisje me kasë fiskale	1
8	Mosafishim liste çmimesh	2
9	Mall pa faturë	6
10	Mosmirëmbajtje kase fiskale	3

Që prej muajit Nëntor 2021 STA ka marrë në ndjekje dhe Ankesat që vijnë nga **Portali i Bashkëqeverisjes**, dhe në total janë administruar **19 Ankesa** nga të cila 18 janë ezauruar dhe 1 është në ndjekje nga Drejtoria e Hetimit Tatimor.

X. MARRËDHËNIET DHE KOORDINIMI INSTITUCIONAL DHE MENAXHIMI I PROJEKTEVE

1. Hyrje

1.1 Përshkrim i shkurtër i DMJMP

Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Menaxhimit të Projekteve (DMJMP) është në varësi të zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Mbështetjes së Programeve.

DMJMP organizon dhe koordinon marrëdhëniet dhe bashkëpunimin dypalësh të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me organizma ndërkombëtarë, në zbatim të aktiviteteve të Administratës Tatimore Shqiptare; siguron harmonizimin dhe koordinimin e të gjitha projekteve me financim të brendshëm apo të huaj që zhvillohen në Administratën Tatimore Shqiptare dhe që ndërlidhen me bashkëpunimin vendas apo ndërkombëtar, përfshirë Administratat Tatimore, Organizatat Ndërkombëtare.

1.2 Detyrat funksionale

Detyrat funksionale të DMJMP-së janë:

- Propozon dhe harton kërkesat për asistencë ndërkombëtare.
- Analizimi dhe kontrolli i ecurisë së projekteve që zhvillohen në DPT.
- Siguron mbarëvajtjen e bashkëpunimit dhe marrëdhënieve dypalëshe të administratës tatimore me organizmat e huaja.
- Raporton lidhur me proceset e integritetit të vendit në BE në strukturat e linjës, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Integritetit European.
- Bashkërendon punën me Drejtoritë e tjera në DPT dhe Drejtoritë Rajonale për pjesëmarrjen e personelit të administratës tatimore qendrore në programet dhe trajnimet e zhvilluara nga organizmat ndërkombëtarë si dhe në vizitat e kryera në kuadër të bashkëpunimit dypalësh.

1.3 Struktura

Me ndryshimet e strukturës më të fundit organizative të DPT, prej muajit korrik 2020 DMJMP përbëhet nga 1 Drejtor + 2 përgjegjës sektori + 6 inspektorë.

1.4 Stafi aktual

- Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë: 1 përgjegjës sektori, 1 inspektor, 1 vend vakant.
- Sektori i Koordinimit të Projekteve: 1 përgjegjës sektori; 2 inspektorë; 2 vende vakant.

2. Objektivat për vitin 2021

2.1 Objektivat strategjikë të DMJMP

Objektivi strategjik 3: Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore.

3.1 Aplikimi i metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një AT moderne

3.4 Zhvillimi dhe përmirësimi i partneriteteve

2.2 Treguesit kryesore të performancës

- Kontribut në grupin e punës të ngritur për zbatimin e projektit pilot mbi shkëmbimin automatik të informacionit sipas standardeve të OECD.
- Koordinimi i punës me Drejtoritë e përfshira në Fazën Fillestare të projektit të asistencës së ofruar nga administrata tatimore e Suedisë.
- Përmirësimi i njohurive të stafit, përmes pjesëmarrjes sa më të gjerë në trajnimet e organizuara nga organizatat ndërkombëtare, vizitave studimore në administratat homologe apo sjelljes së ekspertëve të huaj të fushave të caktuara.
- Menaxhimi dhe koordinimi i kontributit të DPT në procesin e integritetit në BE.

3. Aktivitetet e programuara dhe realizuara gjatë 2021 në funksion të realizimit të objektivave.

3.1 Sektori për Marrëdhëniet me Jashtë

- Raportime periodike të DPT në kuadër të: Kapitulli 16 “Tatimet”, Kapitulli 33 “Dispozitat financiare dhe Buxhetore”, Kapitulli 20 “Sipërmarrja dhe Politikat Industriale”, nënkomitetet “Për çështjet ekonomike, financiare dhe statistika” (ECOFIN), “Tregtia, Industria, Doganat dhe Tatimet - (TIDT)”, KSA, PFM (Public Finance Management); ERP 2022-2024 (Economic Reform Program).
- Organizimi i trajnimeve ndërkombëtare për stafin e AT. (Realizuar 23 trajnime online)

- Aplikimi per TAIEX: harmonizim Direktivash BE - taksa direkte dhe indirekte.
- Koordinimi i punës për lidhjen e Marrëveshjes se re Fiscalis 2021-2027 dhe për amendimin e Marrëveshjes së përdorimit te sistemit CTS të OECD-së.
- Koordinimi i punës për plotësimin (nga Drejtoritë e përfshira ne DPT) e pyetësorit të konfidencialitetit të të dhënave në DPT; ndjekja e procedurave administrative me OECD.

3.2 Sektori i Menaxhimit të Projekteve

- Koordinimi i punës për zbatimin e projektit pilot mbi shkëmbimin automatik të informacionit sipas standardeve të OECD.
- Koordinimi i punës me Drejtoritë e përfshira ne Fazën Fillestare të projektit të asistencës së ofruar nga administrata tatimore e Suedisë.
- Organizimi dhe koordinimi ne DPT i angazhimeve lidhur me asistencën nga FMN dhe organizma të tjerë (Banka Botërore, etj.).

3.3 Projekti për Shkëmbimin Automatik të Informacionit

U finalizua zbatimi i projektit “Shkëmbimi Automatik i Informacionit”. Ky projekt bazohet në Ligjin Nr. 146/2013, datë 06.05.2013 “Për Ratifikimin e Konventës për Ndihmën Administrative të Ndërsjelltë në Çështjet Tatimore”, i cili në nenin 6 të tij ka parashikuar që vendet shkëmbejnë automatikisht informacionin tatimor si dhe në “Marrëveshjen Shumëpalëshe të Autoriteteve Kompetente për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarive Financiare”, nënshkruar më datë 29.10.2014, miratuar me VKM Nr. 178, datë 09.03.2016.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në adoptimin dhe zbatimin e Shkëmbimit Automatik të Informacionit në llogaritë financiare për qëllime tatimore, sipas standardeve të përbashkëta të raportimit.

Gjatë viti 2021 u realizua certifikimi nga OECD i konfidencialitetit dhe sigurisë së të dhënave në administratën tonë tatimore (me disa rekomandime), e në vijim u krye shkëmbimi i parë reciprok i informacionit me administratat homologe.

4. Sa dhe si ndikuan këto aktivitete në arritjen e objektivave të përcaktuara.

U realizua me sukses angazhimi i qeverisë shqiptare për kryerjen në vitin 2021 të shkëmbimit të parë automatik reciprok të informacionit me administratat homologe.

Nisi Faza Fillestare e një bashkëpunimi afatgjatë me administratën tatimore të Suedisë, me qëllim ngritjen e kapaciteteve të administratës sonë.

- Koordinimi në DPT për: Çertifikimi nga OECD i konformitetit të legjislacionit shqiptar për AEOI me standardin CRS të OECD.
- Koordinimi në DPT për: Çertifikimi nga OECD i konfidencialitetit dhe sigurisë së të dhënave në administratën tatimore (post-exchange AEOI) –6-mujori II 2022.

XI.BURIMET NJEREZORE

Administrata Tatimore Qendrore, ushtron funksionimin e saj në zbatim të **Strukturës Organizative të miratuar me Urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore”**, solli ndryshime në organizimin e strukturës së Administratës Tatimore Qëndrore.

Ndryshimet strukturore, në zbatim të Urdhrit nr.33, datë 12.02.2020 , të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore", që erdhën si pasojë dhe në zbatim të Rekomandimeve të FMN-së dhe Rekomandimeve të KLSH-së, të cilat nuk ndikuan në numrin e përgjithshëm të personelit të ATQ, mbeten 1450 numër plan punonjësish/nëpunësish, prej të cilëve 1122 janë nëpunës civil dhe 328 janë punonjës të cilë trajtohen me dispozita të Kodit të Punës.

Për domosdoshmërin e ndryshimeve strukturore jemi shprehur në raportimin vjetor të vitit 2020, gjithësesi duke qenë se në vitin 2021 implemetimi i saj përfshin një periudhë të plotë 1-vjeçare funksionimi, aktualisht bazuar dhe ne rekomandimet e KLSH të lëna, po vlerësohet edhe rezultatet e saj në mire funksionimin e administrates tatimore.

Gjithashtu me implementimin e strukturës organizative në korrik 2020 si dhe shpërndarjes së burimeve njerëzore jnaë verifikuar dhe pasqyruar në databazë në vijimësi për të cilat u krye planifikimi në sistemin e DAP dhe u vijua me hedhjen në sistemin on – line administrata.al.

Në kuadër të kryerjes së veprimtarisë funksionale, Komisioni i Posaçëm, si dhe në zbatim të rekomandimeve të KLSH, mbi kontrollin e ushtruar pranë DPT-së në vitin 2020, vendosi të marrë në shqyrtim gjatë vitit 2021, praktikat e plota të gjyqfituesve – ish nëpunës civilë, të renditur sipas kronologjisë së datave përcjellëse nga Drejtoria Teknike dhe Ligjore, për ekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore në cilësinë e sekretariatit teknik ka vënë në dispozicion të komisionit të gjitha materialet e duhura.

Nga mbledhja e datës 10.12.2020 e vijushmëri gjatë vitit 2021 Komisioni i Posaçëm, sipas edhe informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, nëpërmjet tabelës së të dhënave bazë të praktikave gjyqësore, vlerësoi dhe mori në shqyrtim të gjithë databazën, gjithsej 129 praktika gjyqësore.

Gjatë shqyrtimit, Komisioni i Posaçëm, mori në shqyrtim praktikat, së bashku me dokumentacionin e plotë ligjor, të gjyqfituesve të sipërcituar, ku analizoi vakancën e pozicioneve, rëndësinë dhe kriteret e pozicioneve, ndryshimet strukturore, si dhe pozicionimin aktual të gjyq-fituesve, për raste konkrete, në përpudhje me përvojën/eksperiencën, arsimimin dhe për më tepër disponimin e Gjykatës, në zbatim të dispozitivit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të detyrueshëm për t'u ekzekutuar.

Komisioni mori në shqyrtim gjyqfituesit sipas Drejtorive Rajonale të ndara sipas qarqeve dhe në përfundim të analizës së fakteve dhe rrethanave, Komisioni i Posaçëm, vendosi për sistemimin e gjyqfituesve, sipas të dhënave pasqyruar në tabelën bashkëlidhur dhe vendosi pozicionimin e tyre, bazuar në vendet vakante të vëna në dispozicion nga strukturat kompetente, si më poshtë;

Për disa gjyqfitues Komisioni konstatoi se nuk ka mundësi objektive për sistemim në Administratën Tatimore. Në respektim të dispozitave ligjore dhe në mosmarrëveshje të drejtave të gjyqfituesit, propozoi për pamundësi objektive, sistemimin nga DAP, në pozicione pune, në institucione të shërbimit civil, në zbatim dhe të dispozitivit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Përpjesën tjetër të gjyqfituesve, në analizë të vakancës së pozicioneve, rëndësisë dhe kriterëve të pozicioneve, ndryshimet strukturore, si dhe pozicionimin aktual të gjyq-fituesve, për raste konkrete, në përpudhje me përvojën/eksperiencën, arsimimin dhe për më tepër disponimin e Gjykatës, në zbatim të dispozitivit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të detyrueshëm për t'u ekzekutuar, komisioni vijoi me praktiken për marrjen e pëqimit për pozicionet e ofruara. Aktualisht jemi në procedurë , duke nxjerrë akt rekoamndimet për gjyqfitues të cilët kanë pranuar pozicionin e ofruar dhe përgjigje për pretendimet e gjyqfituesve të cilët nuk kanë pranuar pozicionin e ofruar.

Rekomandime të FMN-së (2020-2021)

- a. Hartimi i një Plani veprimi dhe një kalendarit për nevojat dhe fushat për trajnime (*Aktivitet i realizuar në 2021 sipas programit trajnimeve QTATD/ASPA*).
- b. Hartimi dhe lidhja e marrëveshjeve të ndryshme me administrata të tjera tatimore apo Universitetet me qëllim rritjen e aftësive dhe kapaciteteve, (*Aktivitet i realizuar me nëshkrimin e marrëveshjes me Universitetet në nëntor 2020 dhe realizuar implementimi në vitin 2021 si në zhvillimin e praktikave me studentet e universitetit Tiarnes (fakuleteti ekonomik-juridik) ashtu edhe administratat te huaja siç ka filluar bashkëpunimi me palën Suedeze (ndiqet nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Menaxhimit të Projekteve).*

Aktivitetet ne vitin 2021

1. Hartimi i **planeve vjetore të rekrutimit**; nevojave për personel të përkohshëm; vlerësim i punës dhe performancës; cdo 6 mujor. (Realizuar)
2. **Rishikimi i Treguesve Kyç të Performancës** - të paktën 2 herë në vit. Produkt: Matja e efektivitetit dhe efikasitetit të strukturave të reja të krijuara apo riorganizuar, në bashkëpunim me Drejtoritë përkatëse, mbi bazë të KPI.

Realizua për 6 mujorin e parë 2021 dhe në proces për 6 mujorin e dytë 2021 për nxjerrjen e rezultateve përfundimtare për shkak të situatës COVID-19.

Me shkresën nr.10925 datë 16.06.2021 është kërkuar matja e KPI për 6 mujorin e parë 2021 për strukturat e kontrollit tatimor, borxhit tatimor dhe ka përfunduar ky proces rezultat sipas DRT për strukturat e kontrollit dhe sipas Rajonave për borxhin (bashkelidhur në tabelën me dhënat përkatëse). Me shkresën nr. 22380, datë 15.12.2021 është kërkuar matja e KPI për 6 mujorin e dytë 2021 për strukturat e kontrollit tatimor, borxhit tatimor por ky proces mbyllet me datë 31.12.2021. Për strukturat e tjera pritet miratimi nga Komiteti Reformave.

3. **Hetimi administrativ dhe ndjekja e procedimeve** (vjetore).

Për vitin 2021 janë trajtuar 43- fillime ecurie disiplinore (Total) sipas procedurave të percaktuara në Ligjin nr: 152/2013 "Për nëpunësin civil" I ndryshuar, dhe akteteve nënligjore në zbatim të tij për nëpunës pjesë e shërbimit civil dhe sipas Rregullores Nr. 10, datë 30.01.2020 "Për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil në administratën tatimore qendrore". (Në vijim tabela dhe të dhënat për rezultatet)

4. **Analizimi** dhe marrja e masave pas daljes së rezultateve të **anketimit**/pyetësorëve.

Pas përpilimit të anketeve të pyetësori nga DSHT në bashkëpunim me DBNJ është dërguar me internet (email zyrtar) stafit të ATQ dhe me datë 19.11.2021 kanë dalë rezultatet e anketimit të dhënat e të cilave disponohen nga DBNJ. (Realizuar).

5. Zbatimi i **Marrëveshjes me Universitetet** në trajnimin e punonjësve të administratës tatimore dhe bashkëpunimi për kryerjen e praktikave 3-6 mujore të studentëve pranë Administratës Tatimore. Produkt: Zhvillimi dhe **rritja e aftësive profesionale të stafit** të administratës tatimore, mbështetje profesionale për studentët, bashkëpunimin për studime të përbashkëta për tema diplome dhe doktorature, mundësia e hapjes së një programi studimi të ciklit të dytë Master në fushën fiskale. (Realizuar).

Sipas Marrëveshjes së miratuar me shkresën nr. 3356 prot., datë 27.11.2020 të Universitetit të Tiranës, protokolluar me tonen nr. 22976 prot., datë 27.11.2020 me Univesitetin e Tiranës (fakulteti Ekonomik dhe Drejtësisë), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka ofruar mundësimin e mbështetjes profesionale të studenteve me zhvillimin e praktikave 3-6 mujore për studentet pranë Admisitratës Tatimore Qendrore (ATQ). Për vitin 2021 kanë kryer praktiken gjithësej 80 studente të Fakultetit Ekonomik/Juridik të cilët janë pajisur me certifikate.

- DBNJ, me datë 23. 06.2021 ka organizuar Konferencën e parë Kombëtare në bashkëpunim midis Universitetit të Tiranës Fakulteti i Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve "Konferenca Shkencore Kombëtare" me temë: “MJEDISI FISKAL NË TË CILIN OPERON ADMINISTRATA TATIMORE. PERFORMANCA E ADMINISTRATËS TATIMORE NË SHQIPËRI.

Marrëveshjet me Administratën të huaja Tatimore ndiqet nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Menaxhimit të Projeketeve dhe konkretisht gjatë vitit 2021 ka pasur një bashkëpunim me palën Suedeze.

6. Zhvillimi i testimeve për njohuritë e përfituara gjatë ushtrimit të detyrave për nëpunësit e strukturave të kontrollit tatimor dhe shërbimit të tatimpaguesve.

Për shkak situatës së Covid 19, DAP me shkresë Nr. 473 Prot., datë 16.03.2021 “Kthim përgjigje” ka shtyrë procesin për tre mujorin e fundit 2021, por akoma ska një përgjigje në vijim të kërkesës tonë të përsëritur me shkresën nr. 17260, datë 23.09.2021, për planifikim dhe zhvillim testimi për njohuritë shpesh të nëpunësve të disa strukturave në administratën tatimore.

Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore

Gjatë vitit 2021 janë trajnuar gjithësej **1370 punonjës**, në zbatim të plotë të programit vjetor të trajnimeve për vitin 2021 të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, me Vendimin nr. 1, datë 07.01.2021 “Për Miratimin e Programit Vjetor të Trajnimit të Administratës tatimore Qendrore për Vitin 2020”, si dhe programin e trajnimeve të miratuar me vendimin nr. 1 datë 21.01.2021 nga Bordi i MFE (Akademië Fiskale), bazuar në kalendarin e trajnimeve sipas temave të miratuar , në bashkëpunim me QTATD/ASPA.

1. Zbatimi i plotë i programit të trajnimit për vitin 2021 përfshin:
 - a. Trajnimi i nëpunësve/punonjësve të rinj dhe punonjësve ekselent të rekrutuar në administratën tatimore gjatë vitit 2021. Temat e trajnimit të zhvilluara sipas kalendarit që lidhen me përfitimin e njohurive baze për çështjet tatimore (Shërbimin tatimpagues, mbledhjen me force, kontrollin tatimor etj), organizimin e administratës tatimore, marrëdhëniet e punës në administratën

tatimore, kodin e etikes, konfliktin e interesit si dhe për mashtrimet në fushën e tatimeve (evazioni fiskal), për njohurit bazë për legjislacionin e taksave nacionale dhe lokale etj.

- b. Trajnimi nëpunësve ekzistues për temat e trajnimit të zhvilluara sipas kalendarit të miratuar nga QTATD (bordi MFE) që lidhen me çështjet tatimore dhe legjislacionin tatimor në tërësi si dhe tema në lidhje me evazionin fiskal në fushën e tatimeve.
- c. Trajnimi i nivelit drejtues (Drejtor Drejtorie/Përgjegjës Sektori) për menaxhimin e punës i zhvilluar pranë QTATD me temat e trajnimit sipas kalendarit të trajnimeve por edhe trajnime të ndjekura online nga stafi sipas programit të trajnimit të ASPA.
- d. Trajnimi i punonjësve të strukturave të hetimit tatimor për legjislacionin tatimor dhe verifikimit në Terren.

Realizmi i programit trajnimeve për vitin 2021			
DPT/QTATD			
PËRMBLEDHËSE E TRAJNIMEVE 2021(TATIME)			
	Tatimet		
Periudha	Të trajnuar	Tema	Orë
Janar 2021			
Shkurt 2021			
Mars 2021	51	7	21
Prill 2021	51	4	12
Maj 2021	142	3	12
Qershor 2021	154	3	9
Korrik 2021	396	5	15
Gusht 2021	80	1	5
Shtator 2021	130	1	2
Tetor 2021	264	5	15
Nëntor 2021	61	3	9
Dhjetor 2021	60	2	6
Totali	1389	34	106
Totali të trajnuar (tatime)	1389		
Totali temat (tatime)	34		
Totali orë (tatime)	106		

Trajnime të tjera jashtë programit të planifikuar dhe zhvilluara janë:

1. Zhvillimi i trajnimeve të tjera bazuar në nevojat e strukturave të hetimit tatimor në bashkepunim me institucionet e pavarura (Prokurorinë) me temë: “Evazioni fiskal në fushën e tatimeve”.
2. Trajnime pranë MFE, me strukturën e auditimit, trajnim për kontabilitetin me strukturën e statistikës dhe kontabilitet.

3. Trajnime prane ASPA për tema specifike te kërkuar nga DPT: “Certifikatë sigurisë” si dhe trajnime të tjera sipas programit trajnimeve per vitin 2021 ku në total jane trajnuar rreth 54 nëpunës.
4. Në bashkëpunim me QTATD/ASPA, për vitin 2021 përfundoi trajnimi dhe testimi për 51-nëpunës në periudhë prove, të cilët kaluan testimin dhe kanë përfituar certifikatën pranë ASPA. U trajnuan dhe testua prane QTATD - 5 punonjës ekselent dhe punonjes strukturave hetimit dhe verifikimit ne terren per periudhen e proves 3 mujore të cilët kanë përfituar certifikatën pranë QTATD.
5. Jane trajnuar per procesin e fiskalizimit gjate vitit 2021 (1863 punonjes për tema të ndryshme ku një punonjës ka marrë pjesë në disa tema trajnimi për shkak të funksionit), nderkohe ky informacion i detajuar ndiqet nga DSHT. Gjatë vititi 2021 është zhvilluar testimi i 860-punonjesve e administratës tatimore për njohurite e përfituar nga trajnimet e kryera me teme mbi ligji e fiskalizimit.

Masat disiplinore

a. Procedura disiplinore të filluara dhe përfunduara në 2021.

Në lidhje me procedurat disiplinore të trajtuara për vitin 2021, janë filluar ecuritë disiplinore për 43 nëpunës/punonjës të administratës tatimore qendrore.

Janë shqyrtuar dhe zbardhur vendimet përfundimtare nga Komisioni i Disiplinës për 23 ecuri disiplinore për nëpunës civil që trajtohen sipas dispozitave të ligjit mbi shërbimin civil, vendime të cilat janë përcjellë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore organeve kompetente brenda afateve të parashikuara në ligj.

Dy masa disiplinore janë trajtuar nga eprori direkt.

Për punonjës që trajtohen me dispozitat e Kodit të Punës janë zbardhur gjithsej 12 vendime sipas procedurave të parckatuara në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, Nr. 10, datë 31.01.2020 “Për miratim e Rregullores për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil në Administratën Tatimore Qendrore”.

Tabela e masave disiplinore të punonjësve Administratën Tatimore Qendrore për vitin 2021

Vendime te vitit 2021		Per ecuri 2021
A. Masa te dhena per punonjes te		23
1	Largim nga Sherbimi Civil	1
2	Mbajtje page	0
3	Pezullim ngritje ne detyre	3
4	Nxjerrje jashte juridiksioni	1
5	Verejtje	2

6	Ndërprerje e Ecurisë disiplinore	16
B. Masa te dhena per punonjesit me Kod		12
1	Zgjidhje e menjehereshme e kontrates se	3
2	Verejtje me shkrim	6
3	Verejtje me paralajmerim	3
4	Ndërprerje e Ecurisë disiplinore	0
GJITHSEJ		35
Në proces		8
TOTAL FILLIM ECURIE DISIPLINORE		43

Të dhënat për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021

Për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021 procesi i vlerësimit të rezultateve të punës, është përmbyllur për të gjithë nëpunësit e administrates tatimore dhe janë hedhur në sistemin HRMIS, konform procedurave të përcaktuara në ligjin Nr.152, datë 30.05.2013 “Për nëpunësit civil”, dhe VKM 109, datë 03.05.2014, i ndryshuar, me VKM Nr. 252/2016.

1. Vlerësimet e nëpunësve civil në Administratën Tatimore 6 –mujori I 2021

Nr	Pozicioni punes	Gjithsej	Niveli i vlerësimit			
			Shume mire	Mire (2)	Kenaqshe	Jo kenaqshem
1	Specialist	188	36	149	3	0
2	Inspektor	515	82	431	2	0
3	Përgjegjës Sektori	97	46	51	0	0
4	Drejtor Drejtorie	34	16	18	0	0
5	Drejtor Rajonal	14	8	6	0	0
6	Zv.Dejtor i	2	2	0	0	0
GJITHSEJ		850	190	655	5	0

Procesi i vlerësimit të punës për 6-mujorin e dytë të vitit 2021, është në proces përfundimi dhe do vijohet me fazën e hedhjes në sistemin HRMIS dhe administrimit në dosjet e personelit.

2. Vlerësimet e nëpunësve civil në Administratën Tatimore 6 –mujori II 2021 (e papërfunduar plotësisht)

N	Pozicioni punes	Gjithsej	Niveli i vlerësimit			
			Shume	Mire (2)	Kenaqshe	Jo kenaqshem
1	Specialist	107	25	82	0	0
2	Inspektor	186	22	164	1	0
3	Përgjegjës Sektori	46	16	28	2	0
4	Drejtor Drejtorie	17	7	9	0	0
5	Drejtor Rajonal					
6	Zv.Dejtor i					
GJITHSEJ		356	70	283	3	0

Mungon:

Nuk ka përfunduar procesi për vlerësimet për DPT, DTM, DRT Tiranë, DRT Fier, DRT Sarandë, Drejtoret Rajonal, ZV. Drejtoret e Përgjithshme, për shkak të situatës shëndetësore të punonjësve (covid).

3. Bazuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve Nr. 10, datë 31.01.2020 “Për Miratim e Rregullores për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil, në Administratën Tatimore Qendrore”, për strukturat të cilat trajtohen sipas dispozitave të Kodit të Punës, konkretisht vlerësimet të strukturës së Hetimit Tatimor dhe Verifikimit në Terren Administratën Tatimore(janë në proces) dhe punonjësit e tjerë të shërbimeve mbështetëse janë vjetore.
4. Vlerësimi vjetor i rezultateve në punë për punonjësit me Kod Pune në Administratën Tatimore për vitin 2021.

Nr	Gjithsej	Niveli i vlerësimit			
		Shume mire (1)	Mire (2)	Kenaqshem (3)	Jo kenaqshem (4)
1	75	20	54	1	0

Mungojnë:

Vlerësimet për DTM, DRT Tiranë, DRT Fier dhe DRT Sarandë, për shkak të situatës shëndetësore të punonjësve (covid 19) nuk janë përcjell formularët e vlerësimit për shkak të pamundësisë të nënshkrimit nga nëpunësit.

XII. BUXHETI DHE FINANCA

Tabela 1. Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve Viti 2021

ne
000/leke

Emri i Grupit	Ministria e Financave					Kodi i Grupit	10	
Programet		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit						
		(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	(2) PBA Viti 2021	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	(5) Buxheti Vjetor Plani 2021	(6) Fakti 12 Mujori 2021	(7)=(6)-(5) Diferenca
Titulli	Emertimi							
01140	Menaxhimi i te Ardhurave Tatimore	14,645,518	2,858,900	3,204,306	3,515,432	3,515,432	3,381,153	-134,278.9
0002	Programi 2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
0003	Programi 3	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
0004	Programi 4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
0005	Programi 5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
.....							
Totali i Shpenzimeve te Ministrise		14,645,517.5	2,858,900.0	3,204,305.7	3,515,431.7	3,515,431.7	3,381,152.8	-134,278.9
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit								
Totali		14.645.517.5	2.858.900.0	3.204.305.7	3.515.431.7	3.515.431.7	3.381.152.8	-134.278.9

Tabela 2. Raporti i Shpezimeve sipas artikujve buxhetore Viti 2021

								Kodi i Grupit	10
Emri i Grupit	Ministria e Financave							Kodi i Programit	1140
Programi	Menaxhimi i te Ardhurave Tatimore	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	
Art.	Emertimi	Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	PBA Plan Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/ progresiv	Fakti i Periudhes/ progresiv	Diferenca	
600	Paga	1,228,606	1,480,000	1,420,000	1,274,770	1,274,770	1,264,587	- 10,183	
601	Sigurime Shoqërore	202,471	250,000	250,000	216,540	216,540	210,856	- 5,684	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	727,263	817,640	767,640	1,002,796	1,002,796	897,164	- 105,632	
603	Subvencione							-	
604	Transferta Korente të Brendshme							-	

605	Transferta Korente të Huaja	3,132	1,260	2,360	2,510	2,510	2,227	- 283
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	12,068,530		461,306	464,958	464,958	463,533	- 1,425
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	14,230,002	2,548,900	2,901,306	2,961,574	2,961,574	2,838,366	- 123,208
230	Kapitale të Patrupëzuara	6,250	7,000				-	-
231	Kapitale të Trupëzuara	409,266	303,000	303,000	553,858	553,858	542,787	- 11,071
232	Transferta Kapitale							-
Nen - Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	415,516	310,000	303,000	553,858	553,858	542,787	- 11,071
230	Kapitale të Patrupëzuara							-
231	Kapitale të Trupëzuara							-
232	Transferta Kapitale							-
Nen - Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	-	-	-	-	-	-	-
Totali	Shpenzime Kapitale	415,516	310,000	303,000	553,858	553,858	542,787	- 11,071
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti		2,254,242					2,205,690	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		16,899,760	2,858,900	3,204,306	3,515,432	3,515,432	5,586,842	- 134,279

Tabela 3. Projektet e investimeve

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2021	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI për periudhën e raportimit (12-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
M10 0255	Pagesa kontributit vjetor Fiscalis 2021	31,600	2015	2020	31,600				29,367	
M10 0500	Permiresimi I Modulit te Menaxhimit te Kontrollit te Faturimit	1,727,792	2018	2020	1,727,792	523,858	512,787	512,787	1,701,765	Likuiduar
18A V80 6	Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash(dat a center), sistem telefonik voip dhe monitorimi i qendërzuar për DPT/DRT	170,000	2019	2021	170,000	15,000	15,000	15,000	124,965	Në proces likuidimi

18A V81 1	<i>Ngritja e sistemit per shkembimin e informacionit financiar me entitetet e huaja</i>	80,040	2020	2020	80,040	15,000	15,000	15,000	38,700	Në proçes likujdimi
-----------------	---	--------	------	------	--------	--------	--------	--------	--------	------------------------

XIII. DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PROKURIMEVE

Në zbatim të ligjit të buxhetit Nr. 137/2020 Prot., “Për buxhetin e vitin 2021” dhe të Udhëzimit Nr.9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të Udhëzimit Plotësues Nr.4, datë 25.01.2021, “Për zbatimin e buxhetin e vitin 2021”, mbështetur dhe në Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimet Publike” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Drejtoria e Sherbimeve Mbështetëse Ju bën me dije ecurine e realizimit të procedurave të prokurimit dhe realizimin e dokumentacionit tatimor deri në datë 31.12.2021.

Bazuar në parashikimet e regjistrit të prokurimeve të vitit 2021, deri në 31.12.2021, janë realizuar dhe mosrealizuar procedurat e mëposhtme:

<i>Nr</i>	<i>Objekti prokurimet 602</i>	<i>Fondi limit pa tvsh</i>	<i>Lloji i procedurës</i>	<i>Realizimi12/mujorit me tvsh</i>	<i>Statusi procedurën e prokurimit</i>	<i>Organi qe zhvillon procedurën e prokurimit</i>
1	Shpenzime per mirëmbajtje të mjeteve të transportit	2 500 000	Marrëveshje Kuader dy vjecare,nga viti 2020 me operatorin : ALSTEZO Nr.42/41 date 19.10.2020	2 999 100	Minikontrata Nr.6368/4 date 12.05.2021 Minikontrata Nr.10083/5 date 21.07.2021 Minikontrata Nr.19416/3 date 15.12.2021	ABP
2	Shpenzime blerje , gome	1,250 000	Marveshjes Kuader date 14.01.2021 nga viti 2020 me operatorin : Klosi-R Comany	1 385 894	Minikontrata Nr 7380/3, date 30.06.2021 Minikontrata Nr 20930/4, date 28.12.2021	ABP

3	Shpenzime blerje (Tонера)	16 666 667	Infosoft office Marveshjes Kuader date nga viti 2019	3 585 485	Minikontrarte date 17.06.2021	ABP
4	Shpenzime blerje (leter)	6 250 000	Gjergji Kompjuter Marveshje Kuader Nr.15/13, date	6 249 929	Minikontrarte date 28.12.2021, nr.2158/0/3	ABP
5	Shpenzime blerje kancelari : me baze leter dhe kancelari te tjera	2 000 000		0		ABP
6	Blerje Karburant	14 052 500	Marveshjes Kuader nr 45/12, date 17.09. me operatorin : KASTRATI	16 863 000	Minikontrarte date 15.12.2021, nr.19277/3	ABP
9	Sigurimi i Godinave të Administratës Tatimore	8 000 000	BOE Albsig+Atlantik	7 970 000	Kontrata e realizuar Nr.11285/7 date 27.08.2021	DPT
10	Blerje Kuti Arkive	3 760 000	Kristalina -KH	4 080 000	Kontrate e realizuar Nr.5439, date 19.03.2021	DPA

Për procedurat e mirëmbajtjes dhe të investimeve të realizuara nga AKSHI për 12 mujorin 2021, do ju dorëzohet në një kohë të më vonshme pasi të na vihet në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit pas rakordimit me thesarin.

Blerjet e Vogla të realizuara 31.12.2021

1	Materiale për pastrim shërbim e ngrohje	BV	Mall	375 000		realizuar
2	Shpenzime per materiale tjera zyre dhe	Kontrat	Mall	208333		Pa realizuar
3	Shpenzime blerje dokumentacioni	Kontrat	Mall	83 333		Pa realizuar
4	Kosto e sigurimit te mieteve te transportit	Kontrat	Sherbim	600 000	Albsig K42108801C dt.28.12.2020	realizuar
5	Shpenzime te tjera operative	Kontrat	Mall+Sherbim	83 333	Bashkia Tirane	realizuar
6	Shpenzime te taksave te paguara	Kontrat	Sherbim	416 667	DPTRR	realizuar

7	Shpenzime material informuese, video	Kontrat	mall	800 000	Kristalina -KH /K11501002D	realizuar
8	Shpenzime per mirembajtje per objekte	Kontrat	Pune	800 000	Arkad Iljazi K31713070M	realizuar
9	Shpenzime per mirembajtje aparate	Kontrat	Pune	750 000	Read 2000 I71718029K	realizuar
10	Mirembajtje kondicionimi	Kontrat	Sherbim	416 667	Altec k57923807W	realizuar
11	Shpenzime per materiale dhe sherbime	Kontrat	Sherbim	12 500	Ministria e Brendshme Dreitoria e Policis se Shtetit	realizuar
12	Sherbim monitorim mediatik	Kontrat	sherbim	800 000	Media Intelligence/ M01726015E	realizuar

Për Sektorin e Shërbimeve të Brendëshme janë ndjekur Kontratat e Dokumentacionit Tatimor të cilat janë realizuar deri me 31.12.2021 si me poshtë:

Realizimi i kontratave për vitin 2021 të biletave të transportit rrugor me "Shtypshkronjën e Letrave me Vlerë" deri me 31.12.2021

Kontrata nr.908/3;dt.22.01.2021; nr.15926/2 03.09.2021;nr.20282/2 dt.18.11.2021

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Realizimi	Realizimi në %
1	Bileta Transporti Urban	blloqe	480 000	480 000	100%
2	Bileta Transporti Ndërkombëtar	copë	105 000	105 000	100%
3	Bileta të Pajtimet Mijor (Abone)	copë	1 300 000	844 106	64.9%
4	Bileta Transporti Ndërqytetas	blloqe	50 000	46 700	93.4%

Realizimi i kontratave për vitin 2021 të pullave me "Shtypshkronjën e Letrave me Vlerë" deri me 31.12.2021

Kontrata nr.908/1;dt.22.01.2021; 14539/3, date 27.08.2021;15926, 03.09.2021

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Realizimi	Realizimi në %
1	Pulla takse 50 leke	cope	2 117 000	2 115 000	99.9%
2	Pulla takse 100 leke	copë	678 000	566 000	83.6%
3	Pulla tarife 200 leke	copë	1 498 000	1 494 000	99.7%
4	Pulla tarife konsullore 200 leke	cope	765 000	595 000	77.8%
5	Pullë konsullore 10 E	copë	34 000	17 000	50%
6	Pullë konsullore 20 E	copë	34 000	17 000	50%
7	Pullë konsullore 30 E	copë	51 000	51 000	100%

Realizimi i kontratave për vitin 2021 të dokumentacionit tatimor deri me 31.12.2021:

Kontratat

Nr.907/2 Dt.22.01.2021;Nr 507/4; dt.05.02.2021; 6787/2dt.15.04.2021;12558/2 06.07.2021;nr.20921 dt 18.11.2021

Nr.	Artikulli	Njësia	Sasia	Realizimi	Realizimi në %
1	Faturë tatimore shitje	bllok	89 000	89 000	100%
2	Faturë shoqërimi	bllok	32 000	32 000	100%
3	Faturë e thjeshtë tatimore	bllok	43 875	24 000	55%
	Faturë e thjeshtë tatimore (Format I Ri)	bllok	38 000	38 000	100%
4	Dëftesë tatimore (me tvsh)	bllok	13 800	13 800	100%

Për Sektorin e Shërbimeve të Brendëshme

Problematik ngelet mungesa e magazinave për të depozituar mallrat pas përfundimit të procedurave të prokurimit. Jemi të detyruar që mallrat që kanë volum, (rikupero që duhet ti marrim nga operatori të cilat dalin nga riparimin e automjeteve) ti lëme të magazinat e distributorëve. Me lindjen e nevojës për akomodim të punonjësve të rinj jemi detyruar që të lëvizim dhe ato pak hapsira që i përdornim për magazina dhe kemi marrë kioska në përdorim për magazinim (të cilat përseri janë të pamjaftueshme) deri në momentin që do bëhet një rikonstruksion i ambienteve.

Informacion për problematikat e Sektorit të Prokurimeve.

Procedurat të cilat do të zhvilloheshin nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara (MB) për vitin 2021 janë : “*Blerj Leter, Kancelari, Toner*”. Kjo Agjenci (këtu e në vijim “ABP”), kanë vonuar procedurat e prokurimet që ne i kemi nisur që në muajin nëntor 2020 në MB dhe kjo na ka krijuar vështirësi sidomos në kancelari me bazë leter (zarfe). DPT me shkresë nr.15290 prot., date 20.08.2021, ju kemi kërkuar informacion për statusin e prokurimeve dhe në përgjigjen e marrë me shkresë nr 15290/1, datë 01.09.2021 nga kjo agjenci theksohet se: *kjo procedur është pezulluara për arsye ankimesh dhe nisur nga afatet kohore minimale (pa përfshirë periudhat e pezullimeve për shkak ankese) bazuar në LPP, duhe të paktën 60 ditë nga dita e publikimit deri në dërgimin e autorizimit të lidhjes së kontratës nga OQB.*

Me miratimin e strukturës së re të administratës tatimore qendrore me Urdhrin e Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020 “Për miratimin e Strukturës Organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”. nevojitet planifikim në buxhetin shtese për 2021, bazë materiale për punonjësit shtesë sipas kësaj strukture dhe sidomos për kompjutera pasi kemi katër vjet pa prokuruar pajisje elektronike.

Nevojë e domosdoshme është prokurimi i bazës materiale më të domosdoshme , karrike dhe tavolina, kompjutera.

XIV. DIBA

Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) në DPT, në përmbushje të detyrave të saj funksionale referuar Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2021, ka kryer verifikimin/investigimin për 47 (dyzetë e shtatë) ankesa dhe denoncime, si më poshtë:

- 21 (njëzet e një) çështje janë regjistruar dhe investiguar.
- 10 (dhjetë) punonjës janë konstatuar me shkelje ligjore dhe janë referuar në Komisionin e Disiplinës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- 26 (njëzet e gjashtë) raste të verifikuara dhe të investiguara nga Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion), nuk plotësojnë kushtet dhe nuk përmbajnë elementët për tu regjistruar si çështje.

XV. Drejtoria e Kontrollit të Specializuar

Objektivat e Drejtorisë

Drejtoria e Kontrollit të Specializuar është një drejtori e re, krijuar së fundmi (si pasojë e ndryshimeve organizative miratuar me Urdhërin e Kryeministrit Nr.33 date 12.02.2020), me fokus nxitjen e përmbushjes vullnetare për individin në funksion të realizimit të objektivave të AT.

Struktura Organizative

Struktura organizative e DKS është e përbërë nga 9 inspektorë dhe 1 Drejtues, ku aktualisht janë të emëruar 4 inspektorë (shkurt 2021) dhe drejtori (shkurt 2021).

Kjo drejtori ka qënë një ndër rekomandimet e FMN-së, e cila po jep asistencë të vazhdueshme për të krijuar një drejtori me qasje të integruar risku për individin. Asistenca nga FMN ka filluar në Dhjetor të Vitit 2020 dhe deri me tani, realizuar 3 faza trajnimi.

Duke qënë se kjo drejtori është një fushë e re për AT, DKS ka ndjekur dhe po ndjekë në mënyrë të vazhdueshme udhëzimet dhe rekomandimet e FMN –së, standarte të OECD-së, si më poshtë:

Sipas rekomandimeve të lëna nga FMN, DKS ka zhvilluar këto aktivitete:

1. Hartuar dhe miratuar Manualit DKS, ku është përcaktuar qartësisht procesi i punës DKS;
2. Hartuar dhe miratuar rregullorja për vlerësimin e individit. Në rregullore është përcaktuar mënyra e funksionimit midis DKS dhe drejtorive të tjera funksionale; Gjithashtu është përcaktuar rruga që do të ndiqet për vlerësimin tatimor.
3. Nga ana e DKS janë hartuar propozimet për ndryshime ligjore dhe propozimet për ndryshimin e rregullores ATQ të detyrave funksionale;
4. Dërguar shkresë palëve të trëta për mbledhje informacioni dhe identifikim i individëve që plotësojnë kushtet për të qënë IP.
5. Analizuar DIVA për 3 vitet e fundit: Të ardhurat bruto nga paga apo shpërblime nga marrëdhëniet e punësimit 57 % ; Të ardhurat bruto nga dividendi 29 % ; Të tjerat (9 burime DIVA) 13 %.
6. DKS ka analizuar DIVA (Deklarata Individuale e të Ardhurave Vjetore) për 3 vitet e fundit, të gjithë informacionin bazuar e ardhur na kërkesat e bëra dhe që ka në dispozicion dhe ka krijuar database prej 100 individëve më të pasur.;
7. Sipas planit operacional DKS të miratuar në 2021 nën asistencen e FMN-së ka hartuar planin e përmbushjes vullnetare dhe deri në mars pritet të fillojë zbatimin I planit të përmbushjes dhe do të vazhdojë zbatimin përgjatë 2022 dhe në vijim, ndërkohë kontrolli i individëve do të fillojë në 2023;

XVI. DREJTORIA PËR PROCESET E BIZNESIT

Varësia sipas strukturës organizative të DPT dhe historiku i krijimit

- ❖ Drejtoria për Proceset e Biznesit (DPB) bën pjesë në funksionet mbështetëse në DPT, në varësi të zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Mbështetjes së Programeve dhe drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së DPB.
- ❖ DPB është krijuar në korrik të vitit 2020, me qëllim përmirësimin, automatizimin dhe lehtësimin e proceseve të punës të Drejtorive funksionale, si dhe analizimin e menyrës së implementimit të proceseve të biznesit, në përputhje me legjislacionin dhe procedurat tatimore.

DPB në bashkëpunim me drejtoritë e tjera bën identifikimin e opsioneve dhe rekomandon opsionin më të përshtatshëm për tu implementuar në mënyrë që zgjidhja IT të përputhet me kërkesat e administratës tatimore, e realizueshme kjo nëpërmjet sektorit të analizës dhe implementimit.

Objektiv tjetër i krijimit të DPB është shkëmbimi i informacionit të llogarive financiare të raportueshme me autoritetet homologe por jo vetëm, edhe me drejtoritë apo institucionet kombëtare sipas kufijve të përcaktuara në ligj, e realizueshme kjo nëpërmjet sektorit të shkëmbimit të informacionit.

Organizimi i Drejtorisë për Proceset e Biznesit

DPB është e organizuar në dy sektore:

- ❖ **Spektori i analizës dhe implementimit të proceseve të biznesit**, me fokus kryesor analizimin e mënyrës së implementimit të proceseve të biznesit, implementimin e ndryshimeve ligjore, automatizimin e proceseve të punës së funksioneve të Administratës Tatimore etj.
- ❖ **Spektori i shkëmbimit të informacionit**, me fokus kryesor në praktiken e shkëmbimit të informacionit të llogarive financiare të raportueshme me autoritetet homologe por jo vetëm, edhe me drejtoritë apo institucionet e tjera kombëtare sipas përcaktimeve ligjore.

Aktiviteti i Drejtorise per Proceset e Biznesit gjate vitit 2021

Në kuadër të realizimit të detyrave funksionale të përcaktuara shprehimisht në Rregulloren e Administratës Tatimore Qendrore, gjate vitit 2021, puna e DPB eshte fokusuar kryesisht ne:

Zbatimin e aktiviteteve per te realizuar objektivat e Planit Operacional, te tilla si:

- Komunikimi me drejtoritë funksionale ne DPT, në lidhje me përmirësimin e proceseve manuale të punës. Pas koordinimit te takimeve dhe analizimit te kerkesave, përveç automatizimit të proceseve të punës, ka lindur nevoja e përditësimeve edhe në manualet e punes apo rregullore të disa prej drejtorive.
- Ndjekja dhe trajtimi i problematikave te raportuara nga tatimpaguesit ne lidhje me procesin e Fiskalizimit
- Testimi i permiresimeve apo zhvillimeve te kryera nga Pala mirembajtese e sistemit te Fiskalizimit
- Krijimi i Regjistrit te te dhenave, për çdo vit raportues në lidhje me numrin e raportimeve në përputhje me Rregulloren si dhe raportimi pranë Strukturave të Kontrollit për Institucionet Financiare të cilat nuk kanë raportuar apo kanë raportuar jashtë afatit sipas detyrimit ligjor për raportimin e AEOL.
- Pjesemarrje ne trajnime në kuadër të asistencës nga STA (Administrata Tatimore Suedeze) në lidhje me AEOL si edhe në lidhje me Proceset e biznesit, si dhe me OECD në lidhje me efektivitetin e AEOL (Automatic Echange Of Information). Aktualisht Administrata Tatimore në lidhje me Shkëmbimin e Informacionit në kuadër të AEOL është duke u asistuar nga OECD dhe Administrata Tatimore Suedeze për përmbushjen e objektivave sipas CRS (Common Reporting Standard – standarti i përbashkët i raportimit).

Bashkëpunimi me palët e treta.

Në kuadër të realizimit të detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Adminsitratës Tatimore Qendrore, Sektori i Analizës dhe Implementimit për zgjidhjen e praktikave të adresuara bashkëpunon me palët kontraktore, palët e treta dhe strukturën Helpdesk të Fiskalizimit si vijon:

- ❖ **IKUB – DPB** dërgon për ndjekje dhe bashkëpunon me IKUB për implementimin e ndryshimeve dhe ndjekjen e problematikave në sistemin E-tax.

- ❖ **BOE** (*Bashkim operatorësh ndërmjet palës kontraktore Kroate dhe Palës kontraktore PRIMUS*) – **DPB** dërgon për ndjekje pra bashkëpunon me BOE për implementimin e ndryshimeve dhe ndjekjen e problematikave në sistemin e Fiskalizimit.
- ❖ **Helpdesk Fiskalizimi** – **DPB** komunikime teknike dhe ndjekje e problematikave të adresuara nga drejtoritë rajonale dhe subjektet pwr procesin e fiskalizimit.
- ❖ Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe Drejtoria për Proceset e Bisnesit ka evidentuar disa nga regjistrat elektronik të palëve të treta që janë të publikuara në GOVNet, dhe në bashkëpunim me AKSHI-n po evidenton mundësinë për shfrytëzimin e të dhënave duke i përfshirë në DataWarehouse e sistemit të fiskalizimit. Disa nga regjistrat të cilat aktualisht merren të dhëna (jo të gjitha në kohë reale), mund të përmendim OSHEE, UKT, Regjistri i Noterëve NISA, Bashkia e Tiranës, DPSHTRR, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, AKEP etj.

Veprimtaritë e kryera dhe në proces

Gjatë vitit 2021 janë ndërmarrë disa përmirësime apo zhvillime të reja në sisteme (E-tax dhe atë të Fiskalizimit), ndër të cilat mund të përmendim:

- Platforma Digjitale e Rimbursimit të TVSH-së në sistemin E-tax
- Formati i ri i Faturës së Thjeshtuar në sistemin e fiskalizimit
- Përmirësim/shtim i kontrolleve për deklaratat model “Ndryshim nga inspektori” në sistemin C@TS
- Bllokimi i lëvizjeve manuale në çështje në sistemin C@TS
- Deklarimi dhe transferimi automatik i librave dhe deklaratës së TVSH-së
- Korrigjimi i faturave të lëshuara përpara fiskalizimit
- Ndryshimet në deklaratën e DIVA për individët
- Kërkesë për ndryshime në modulën e borxhit
- Përmirësimet në deklaratimet e listëpagesave, sipas kërkesave të DMR
- Si dhe të gjitha ndryshimet e kryera në sisteme të cilat reflektojnë ndryshimet ligjore.